BERGUAR PREJ
SOFOKLI ÇAPI
KAIRO

BABA-TOMORRI

Vjérsha

PRÉJ

A. Z. . . . CHAJUP.

— Shqipja qysh u eshte dukur ?
Sa é-embel, sa é-bukur —

Nde KAIRO

1902.

BKSH

BKSH

DY FJALE.

Keto vjérsha qe dalen sot ne drite jane shkruare per te rrefyér qe Shqipja eshte ghuhe si édhé té tjérate, ne mos mé-mire. Ne mos dime t'a kuvendojme a t'a-shkruajme si duéte, eshte sé s' duame t'a msojeme, dhé fajn' é kane: priftrét é hodzet, kisha dhé dzamia, dhé Qéveri é Turqise. Po fajne me te math é-kane ata Shqipetaret qe bésojne te huajte dhé shiténe é kerkojne te shésen dhé Shqiperine!

BKSH

Ch' eshte ghua Ship? thone tsa kokeprishure. Ghua Shqip, o vélezer Shqipetare, eshte ghu' é-Shqiperise; ajo qe na flét mema ne djép; ajo é Skéndérbéut dhé é-shtreghushrévét tone qe kane ndéruare Athéne; ajo é vjérshetorit math Naim béut, qe rjéth si mjalte; ajo é Gazétavét bukura qe dalen ne Bruksél' a ne Sofje é ne Bukurést; ajo é shoqerise « Perlindja, dhé Dituria » dhé ajo é shoqerivét Italise, é te tjéra é te tjéra. . . S'eshte mjaft per te bindure qe kémi ghuhe te bukure?

Po kush shitét mé érghent
Nuke bindéte mé ment. . . .

Keto vjérsha ndaéne me tri pjése pas qelhimit qe kane: 1· Atdhéu; 2· Dashuria; 3· Perralha te rremé é te vertéta. Ne mos jane shkruare mir' é bukur, jane préj zemer Shqipetari, pa ndo gne qelhim tjéter per véch deshira per Memedhéne é per shqipéne, per te cilat tsilhi do memedhétar duet te punoje sa t'-ipéte, pas fuqise q'i-ka dhene Zoti: kush pak, kush shume, po eshte névoje te

punojme te ghithe per Shqiperine.

U lutém memedhétarevét te me ndjéjne per fjalet é huaj que dote ghejene. Po i- mjéri !. kam vjét shume qe jam larguare nga Shqiperia dhé s' munt te thém sé shqipéne é-di mire. Pastaj me dukéte sé nuke duéte te qerojme shqipéne nga ghithe fjalet é huaj, sé ghithe ghute jane lidhure mé gnéra tjéterne dhé jane huare: Ch' imbététe ghuhese Frantsese po te mos két fjalet latinché é élinisché? Ch' i mbététe ghuhese Grékut po te qeronéte nga rregnet' é shqipése?

Nuk' eshte pra turp te shqiperojme fjale te huaj kur eshte névoje, ashtu si kane bere ghithe kombèt é qytéteruare. Gne ghe duéte te kerkojme é t'a harrijme: *Te shkruajm te ghithe mé gne Alfabét.*

Ndaj Shqipetarete qe shkruajne libra é Gazéta duét te mblidhén é te méntonén mire per te perdorur ghithe gne sua shkrogne, per perparimn' é ghuhese tone, é tsila dote sjélhe mbrodhesine é bashkimn' é Shqipetarevét dhé lirin' é Shqiperise...

Nde Kairo, 1902.

BKSH

PJÉS' É-PARE:

ATDHÉU.

BKSH

BKSH

BABA-TOMORRI

Baba - Tomor, Kish' é Shqiperise,
Mal i-larte, fron i-Pérendise,
Ték Ti vinin gnérzite qe-moti
Per te msuar sé ch'urdheron Zoti. . .
Ték Te lutém dhé u duk' é qare
Te msoj ç' thote dhé per Shqipetare.
Kane qene trima te-levduar.
Dhé ne lufte s' jane turperuar,
Qéne trima dhé memedhétare,
Bésa, féa, si-Kishne dhé ndare,

BKSH

Shkonin jéten mé puçke ne dore,
Donin Shqipén, s' qéne tradhetore ;
Lulezonté ghithe Shiqiperia,
S'é-Kish shkélur si sot Roberia,
Gra é burra donin Shqiperine,
Djém é çupa kendonin Lirine.
Sot qysh ghendét Komb' i Shqiperise !
I - permbysur nga zghédh' é Turqise.
Shqipetaret, si dhé baketia,
C' bathur, c'véshur, vdésen nga uria !
Shqipetaret ? Sot s'ka Shqipetare,
Turku, Gréku na kane perndare !
Prifti, hodza, Kisha dhé Dzamia,
Na gegnéjne. . . U prish Shqipperia . . .
Mal i larte, mé Kryé ne diélh,
Fron i Zotit q'eshte mbrét ne qiélh,
Baba - Tomor, o mal' i uruar,
C' Kane Ghare, ghithe ç' Kane skuar.
I di véte, s' duét te Ti thémi ;
Ç, dote ghajne, Te lutém rrefémi,

Sot é tutjé, ç' thote Pérendia?
Dote héqe shume Shqiperia?
Ç' faj ka bere ç' ghynaé paguan?
Nga Turqia te tere shpetuan:
Gréku, Serbi, Velau, Bulgari,
Nene zghédhe mbéti Shqipetari!
Ç' thote Zoti per kombine tene,
Dota lere nene Sultan-qene?
Na Shkrétoi, na préu, na griu,
Na ç' ndéroi, dhé ghakne na piu,
Na mundoi, shpyrtine na nzori! ! !
Fshiu lote dhé me tha Tomorri:

O Shqipetaret' é-ghore
Neghoni Baba-Tomorre:
Kombi juaj s' vété mbare
Sé béset u-kane ndare.

Bésa é bashkon gnérine:
Ju psé ndani Pérendine?

BKSH

Si Ungˈhilhi dhé kurani:
Nuke na diéte fundi;
Mé qiéjte mo u-mbani
Sé nuke mbaén ghikundi.
Te Krishter' é Myslimane
Ghithe gne Pérendi kane;
Ini gne ghak mor te mjêre
Sé nde gne vend kini lére.
Ini ghithe Shqipetare,
S' ini Gréker a Tartare.
Hiqni dore ngˈa rréziku,
Shini s'e ç' punon, armiku
I-pa-bési dhé i-ligu.
Mblidhuni te beni Béne,
Te kujtoni Skendér-béne,
Te duani Memedhéne,
Te mos a lini te shkréte.
Ngrihi ta shpetoni véte
Sé u ndin Zot'i-vertéte
Mos é péshoni Turqine,

BKSH

Mos é bésoni Moréne
Ne duani Pérendine,
Te duani Memedhéne.
Erdhi dita te leftojme
Per lirin' è Shqiperise;
Ja te vdésem, ja te rrojme
Si burrat' é Trimerise.

BKSH

Memedhéu

Memedhé quéte toka
Ku me ka renure koka,
Ku kam dashur mem' é ate,
Ku me gné dhé gur' i-thate,
Ku kam passure shtepine,
Ku kam gnojtur Pérendine,
Shtreghushet ku kane qene,
Dhé varrét q' i kane vene,
Ku jam rritur mé therrimé,
Ku kam folur ghune timé,
Ku kam fis é ku kam fare,
Ku kam qéshur, ku kam qare,
Ku rroj mé gas é mé shprése,
Ku kam deshire te vdése.

BKSH

Shqipetar !

Shqiperin' é-mori Turku
i - vu zjarr !
Shqipetar mos rri po duku
Shqipetar !

Mjaft punové per te tjére
ô fat - kéq !
Kujto vende ték ké lére
dhé ték héq.

BKSH

Te ka bere Pérendia
luftetar,
Si s' te lodhi Roberia
Shqipetar!

– Erdhi dita te ngresh koke,
te kerkosh
Lirine; bashke mé shoke
te leftosh!

Mos beni si kini bere
ghér me djé,
Po te leftoni te tere
per Atdhé:

– Pése qint vjét kémi rruar
mé pahir
Lidhure nga kemb' é duar
mé zindzir! . .

BKSH

- Musylman' é te Krishtere
jémi kéq !
Te ngriémi qe te tere,
djém' é pléq !

Te ngriémi te deftojme
trimeri,
Ja te vdésim ja te rrojme
per liri !

- O moj Shqiperiz' é - dashur
memedhé,
Te sho mé buze te plasur. . .
si me shé.

U shkrétové ane mb'ane
Shqiperi,
Sé Shqipetarete s' kane
dashuri.

BKSH

– Ghithe djémte qe ké qare
dhè mban zi,
Per Moréne jane vare,
per Turqi !

– C' vish robat' é Roberise
memedhé.
Vish armet' é Trimerise
sé ké né !. . .

BKSH

KU KÉMI LÉRE?

Ne c' vend kémi lére?
Ku na bejne ndére?
— Ne Shqiperi.
Po gnériu véte
Tsine do ne jéte?
— Do vend' é-ti.
Ku i-dukét balta
Mé emel sé mjalta?
— Ne Shqiperi.
Ku rrhon mé gne shprése?
Ku kerkon te vdése?
— Ne vend te ti
Ku munt te gezoje
Dhé mé ndér te rroje?
— Ne Shqiperi.
Per sé te punoje
Dhè te lakemoje?
— Per vend' é-ti

BKSH

Trim' i Shqiperise.

Kush ka qene trim gne hére?
Alexandr' i-Math i-vjére,
Pirua mé shoke te tjére,
Ne Shqiperi kane lére.
Po nga te ghithe m' i-zoti,
Skendér-béu Kastrioti.
O mbrét i-dashur ku jé?
Ku jè moré Skendér-bé?
Si duron ti nene dhé?
Nuke te vjén kéq per né?
Qe ditene qe na lé,
Vendi yn u-be *rajé!*. .
Te lutémi dit' é nate,
N' ate jéte ku ké vate,
Dergona shprés' é urate.
Te mos rrojeme si grate. . .
Te ngriémi te leftojme,
Turqit ketéje ti dbojme,
Shqiperine ta shpetojme
Dhé lir é mé ndér te rrojme.

BKSH

Deshir' é Skëndër-béut diten qe vdiq.

Sa rrojta s'u turperuam:
Te ghithe bashke leftuam,
Vendine ten' é-ndéruam
Sé nga Turqit é-shptuam.
Po tani u aferua
Dit' é fundit dhé per mua.
Ghithe kete dite présem,
Kémi lér' é dote vdésem,
Gnéri per jéte s' ka mbétur,
Dhéu te ghith' i-ka trétur;
Po lum kush eshte perpjékur
Dhé per Atdhéne ka vdékur.
Ndaj désha, sa jam i-ghalhe,
Tu mbléth t' u thém keto fjale:

O velézer Shqipetare
U lutém te beni mbare
Ghithe bashk' é te pa ndare.
Mysliman' é te Krishtere
Pérendia na ka bere,
Jémi velézer te tere.

Zoti kur beri insane
Mé gne fytyre te nalte,
Te Krishter' é Myslimane
I gatoi nga gne balte.
Zoti mé te math te-Véte
Eshte gne dhé i-vertéte
Si ketu dhé n'ate jéte.

Si Unghilhi dhé Kurani;
Mos é ndajni Pérendine,
Shoku shokne mos é hani,
Si punojn' ata qe s' dine
Bésa esht é Ghithesise;

Né jémi te Shqiperise
Sé kémi pire gne sise.

PISH

Per Pérendi qe bésoni,
Shqiperine mos harroni
Pra faluni si te doni. . .
Faluni té Pérendia
Te shpetoje Shqiperia
Nga é-ndyra Roberia.
Tani ta shpetoni véte,
Sé une nuke kam jéte,
Véte té Zot' i-Vertéte.
Doti lutém duk' é qare
Te jéte mé Shqipetare
Dhé t' u ape dashurine
Te ndérojne Shqiperine.

BKSH

Sultani.

Jam Sultan, mbrét i-vertéte,
Shoq te tjère s' kam ne jéte;
Ghaketor é zemer-dérr,
Nga frika me bejne ndér!.
Dola nga fund' i Asise
Si rrébésh' i Pérendise:
Vrava, préva é shkrétova!
Boten mé ghak é-mbulova!
Kur zotova Anadolhe
Erdha mora dhé Stambolhe,
Gnérzit i shkova ne thike!
Dhé kush mbéti rron mé frike!..
Jam i-kéq si égercire!
Te urtet jane te mire,
Dua te quém i-marre.

BKSH

Po puna te véje mbare.
Théra Gréker é Bulgare,
Théra Erménet é-mjére,
Théra sa munda te tjére!
Egercire si ariu,
Mé fytyre si gnériu
Me dergoi Pérendia
Qe te vuaj gnérezia!
Evropa qe me shukon.
Te me beje ghe s' guzon
Sé ka méjtimé te tjéra. . . .
Prisha, vrava, préva, théra!
Bera. . . po çh' nuke kam bere?
Prisha botene te tere!
Mysliman é te krishtere
Kam derguar n' ate jéte
Me téper sé ç' vdiqne véte!
Jam i-zoti, rroj mé palhe,
S' dua te sho gnérs te ghalhe!
Nat é dite ghak kerkoj,

Pa pire ghak s' munt te rroj !
Dhé tani q'u beshe plak
Nuke munt te fryém ghak !
Ata qe kam nene zghédhe
Te mundije tok t' i-mblédhe,
Mé dore timé t' i-vrase,
Te pije ghakn' é rajase !
Psé s' u-be, nga Pérendia,
Mé gne koke gnérezia,
Qe ta prése mé gne hére !
Te mos mbétéshin te tjére !
Te mbétéj dhéu i-shkréte,
Sé doje te rroje véte ;
Mé égercira te rroje,
Pa frike te mbréteroje,
Sé me duan é i-dua,
Jémi gne ghak é gne sua !
S' lashe gnéri pa te kéq !
Gra é burra, djém é pléq
Dridhéne kur me kujtojne,

PKSH

Memate me malhekojne,
Me malhekojne te vate
Edhé qajne dit é nate !
Qajne ! po kush nuke qa ?
Qajne burra, qajne gra,
Qajne maléte per pylé,
Qajne fushete per lulé ! . . .
Kudo shkéla u-tha bari !
Ch' la puçka é doghi zjarri ! . .
Egercire si ariu
Hengra dhé u mish gnériu !
Si kam dashur kam punuar,
Psé nuke jam i-gezuar ?
I-lik jam, te liga dua,
Nga kush me vjén frike mua ?
Nuke di sé ch' kam i-ziu,
Nga frika ghaku me ngriu. . .
Mé punera qe kam bere,
Me dukén armiq te tere,
Mysliman é te Krishtere ;
Sa dhé trimat Shqipetare

Zun' é me punojne varre !
Humba Morén' é Vlahine,
Bulgarine mé Serbine,
Bosgnene mé Mal-é-zi,
Ghiritne mé Thésali ;
Késhe kompn' é Shqiperise
Dirék i-ghithe Turqise ;
Psé s' me priti sa te vdése
Pa te me dil i-pa bése !
Mé Shqiperi te leftoném
Kam frike mos turperoném,
Kam frike nga Skéndérbéu
Mos dale prape nga dhéu ! . .
Sé ch' méntoj a ch' jam i-marri
S' me ben dot ghe Shqipetari,
Dhé sa te jém vét i-ghalhe
Nga zghédha s' ka per te dale.
Pas méjé, ne kete jéte
Guri mi gure mos mbéte ! . . .

Prishij' é Lekursit nga Gréku.

Ne Sarande dolhi GréKu,
Ne Lekurs' u-zu dyféku.
O burra! o Shqipetare!
Gréku kerkon te na marre!
O burra! tu hidhémi!
Mos trembi sé s'vritémi
Mé dyfék s' goditémi!
Mé keté ze, nga verria.
U dérdhe chobaneria,
Muarre perpjéte male.
Dhé zune Grékrét te ghalhe.
Tsa i-vran' é tsa i grine?
Tsa i-shpune ne Janine!
Ne dét rane tsa te tjéré!
Po u-prish Lekurs' i-mjére!
O Gréker o koke thate,
Nuke mirrét Shqiperia.
Ertht' é u-zute si grate!
U-turperoj Pérendia! . . .

BKSH

Luft' é vitit 1896

Viti nendedhjét' é ghaste
Dolhi dhé Moréa jashte!
Dolhi Gréku, te leftoje!
Kur t' i-vémi dot na shoje! . .
O Ghirit a pach bélane
Qe zemerové Sultane
Dhé thirri Edém Pashane
Edém pashe kordhetare
Mé pak trima Shqipetare.
Kur rune ne Thésali
Ane mban' é-bene hi,
Sé kur do qu'-zu dyféku
Po si dhia iku Gréku! . .
O Malét' é Dyméqése
Edhé the Thérmopilése,
Falni mé Shendét Morése
Te nisét é te na prése
Te gezojme kete Pashke
Ne Athine ghithe bashke! . . .

BKSH

Vaj.

O Shqipetare te mjére
Ch' u-ka marre koka ére,
Dérthni ghakne per te tjére !
Ghithe trimat é Turqise
Jane djémt' é Shqiperise ;
Ata qe bene Moréne
Ghithe Shqipetare qéne.
Lefton Turku mé Junane,
Po Shqipetarete ch' kane
Q' u-ngréne te ghith' é vane
Tsa me gn'an' é tsa me gn'ane ?
Mysliman' é te Krishtere
Ne lufte vane te tere ;

PKSH

Lane memedhéne shkréte,
Vane te vriténe véte !
Sos vritén per Shqiperine
Po per Morén' é Turqine !
Ne berrul te péndzérése
Qan Shqipetarka pa shprése.
Qan é te keput kaurka !
Per karshi qan édhé Turka !
Qe te dya Shqipetaré
Qajn' é s' pushojene faré,
Sé djémte ne luft' u vane ;
Myslimani per Sultane
I Krishteri per Junane,
Mé gnéri-jéter u-vrane ! . . .
Mem' é-zéze dél me shkalhe,
Qan é ulerin per djale ;
Si burim i-véne lote,
Djalite-vétem i thote :
Bir o bir ne lufte ch' déshé ?
Psé nuke rijé ték jéshé ?

Turkun' é Grékne ch' i - késhé ?
Sos leftonté Shqiperia
Qe nzivé ditet é - mia !
Vajtë [illegible] luft' é me s' érdhé !
S' t' érdhi kéqe [illegible] ghak qe dérdhé ?
Sos é - dérdhé per Atdhéne
Po per Turq' é per Moréné !
Si te ta fal marrezine ?
Sos vdiqé per Sqiperine ?
Per gne dérr' é per gne dhélper :
Per Sultan' édhé per Gréker
Vajt' é humbé kete jéte !
Iké dhé me lé te - shkréte !
Bir o bir ! u mbylh shtepia !
U - shoft' é tere Turqia,
U - shofte dhé Grékuria,
Mos u ghente fis é fare,
Gegnéjne mè Shqipetare ;
Sa mema qe kane qare
Per djémte q' u - jane vrare !

E - zéza qe me la djali !
Bir o bir ! ch' me mori malhi !
Bir o bir ! ch' pune punové !
Pléqerine ma shkrétové !
Djalerin' é Trimerine
S' i - humbé per Shqiperine.
Vajté leftové per bote,
U mundové dem é kote !
Bir o djal' i - véteme
Sé ch' me nzivé jétene ! . .

BKSH

Roberia.

E - dashura Memedhé
Te dua dhé kshtu si jé !
Po kur te te sho te - lire
Do te te dua me mire .

Qajni pujé, fusha, gure,
Qajni malé mé tebore !
Shqiperia mbét é - ghore
Dhé nuke shé drite kurrre :
Gne mjérgul é kéq' é shkréte
E - ka mbuluar per jéte !

Gne gazép, gne érretsire !
Vétetit édhé ghemon !
Rojme mé zemer te ngrire,
Nga frika kurkush s' gezon !
Ngérzite kurre s' kendojne,
Dhé bilbilete vajtojne !

BKSH

Qiaméti shkrétetira ! . .
Zogu vété ze foléne,
Gnériu le Memedhéne
Sé mbréteron égertsira !
Per Shqiperi desherojme
Sé ne vent te-huaj rojme

Roberine si duron
O moj Shqiperi é-mjére ?
Shpetové vendé te tjére,
Véte nene zghédhe rron !
Shqipetare beni béne
Te leftoni per Atdhéne.

E-dashura Memedhé
Te dua dhé kshtu si jé !
Po kur te te sho te-lire
Dote te dua me mire

BKSH

Bésa - bése.

Ghithe vendéte gezojne
Ti Shqiperi psé pushon !
Ghithe gnérzite kendojne
Ti Shqipetar psé renkon ?

Ghithe duane lirine
Dhé pa te gnériu s' rron,
Ti Shqipetar, Shqiperine
Ne zghédhe si é - duron ?

Sghojuni o Shqipetare,
Erdhi dita per Liri :
Zini lutte mé Barbare,
Perpiqi per Shqiperi.

Te Krishter' é Myslimane,
Te tere gne sua kémi :
Gége, Toske, Dibriane,
Ghithe Shqipetare jémi :

BKSH

Mblidhuni te bejme béne
Te ghithe dore per dore:
Te duame Memedhéne
Edhé malét mé tebore.

O malét é Shqiperise
Qe ne Prévéz é ne Kroje,
Egertsira é Asise
Nghére-kur dot' u-zotoje?

Qe ditene qe u-shkéli
Roberia, dhé nghér sot
Nuke ben me bar Dhembéli
Dhé Tomorri qan mé lot! . . .

Malé, mé kryé ne Qiélh,
Si duroni Roberine?
Ju qe shini drit é diélh
Psé s' ndrini dhé Shqiperine?

BKSH

Ku jane vaftét é - pare
Qe kini dhene yrnék !
Ku ini o Shqipetare,
Psé ndeghonét gne dyték ?

Apo humbi trimeria !
Apo s' doni Memedhéne !
A u - shua Shqiperia
Qe ka pjélhe Skéndér - béne ?

Psé rrini lidhur mé lak ?
Psé s' shpetoni vende tuaj ?
Apo s' u - mbéti me ghak
Sé é - dérthte per te - huaj !

Mirri puchkate ne duar
Edhé beni *bésa - bése :*
Shqiperia do shpetuar,
Koke Turku te mos mbése ! . .

BKSH

Ch' jémi ? . . .

Gréku dhé Bulgari,
Dhé Turku Barbari
Nuke dine ch' jane . .
Dhé turp nuke kane !

Névé, Shqipetare,
Jémi komb' i - pare,
Po per turp é - kémi
Te thémi sé ch' jémi

BKSH

Gnéri, do Gréqine,
Tjétri, do Turqine,
Edhé Shqiperine
S' duane t' a - dine !

Ch' jémi ? o te mjére
Jémi Shqipetare,
Si né s' ka te tjére,
Po punoni mbare . . . .

Ne kini, o shoke,
Mendjéne ne koke,
Harroni Moréne,
Dojni Memedhéne.

Nga Turqit largoni.
Dhé me mos i - doni,
Sé armiq na kane
Duan te na - hane !

BKSH

Lini djalbezite,
Lini prapesite. . . .
Po si Pérendine
Dojni Shqiperine.

Vend' i Skéndér-béut,
M' i-bukur i dhéut,
Kur dote gezoje
Dhé te lulezoje?

Balt' é Shqiperise,
Djép' i Trimerise,
E-embel si mjalte. . .
Zoti na é falte!

BKSH

Punerat' é Pérendise.

Zot' i - Math é i - Vertéte
Ch' do pun' é - ké bere véte :
Beré qiéjte dhé déne,
Beré yjete dhé dhéne,
Beré diélhin mé drite,
Beré nat' é beré dite,
Beré érene dhé réte,
Beré pémete mé fléte,
Beré henezen mé yjé,
Beré fusha, malé, pyjé,
Beré zoqte qe kendojne,
Dhé lulét qe lulezojne,
Berè dimer' é béhare,
Beré kuaj dhé gomare,
Beré miser édhé grure,

BIBSH

Po me shume beré gure.
Si beré kaqe te mira
Beré dhé shum' égertsira:
Beré arine dhé dérre,
Beré uqer é te tjére,
Beré . . . Po ch' nuke ké bere?
Beré Botene te tere;
Beré dhé Djalhe mé brire!
Ch', do pun' é-ké bere mire
Po gne ghe beré pa mendé
Dhé prishé punene tendé:
Kur beré dérr' é arine
Ch' déshé qe beré Turqine?
Sé te mos qenkéj kjo fare
Bota dote vintéj mbare,
Dhéu dote lulezonté,
Shqiperia dot' gezonté . . . . .

BKSH

Naim-bé Frasheri

Vdiq Naimi! Vdiq Naimi!
Moj è-mjéra Shqiperi!
Mendjé-larti, zemer-trimi,
Vjérshetori si ai!..

Vdiq Naimi po vajtoni
Shqipetarka, Shqipetare!
Naimne kur t'a kujtoni
Mos pushoni duk'é qare!

Vdiq Naimi, Naim-béu!
Vaté té Zoti-vertéte:
Qysh u-nda nga Memedhéu
Dhé iku é-la per jéte?

BYSH

Vdiq Naimi ! Ghithe thone !
Qajni Turq, qajni Kaure !
Bilbil' i ghuhese tone
S' dote ndeghonét me kurre !

Vdiq Naimi qe kendoi
Trimerine, Skéndér - béne ;
Vdiq Naimi qe levdoi
Dhé ndéroi Memedhéne !

Vdiq Naimi ! po ch' te ghéti
O moj Shqiperi é - mjére
Vdiq Naimi ! po kush mbéti ?
Si Naimi s' ka te tjére.

Vdiq Naimi ! Vdékj' é - shkréte
Psé moré tetilhe burre ?
I - ndrite shpyrti per jéte,
Mos i - vdékte nami kurre !

BKSH

Atdhéu dhé Dashuria.

Vitua, gne pun' é madhé,
E - bukure si zorkadhé,
Nga ghithe shoqéte ch' quan
Dhé ghithe trimat é - duan :
Per tetilhe bukuri
Kush nuke ka dashuri ?
Gne dite qe vij ne krua
Duk' é étsure mi thua,
Poqi gne Turk trim te marre,
Tjéter hére s' é - kish pare
Robate qe kish i - ndrinin,
Dhé armet' i - vétetinin !
Kur shtiu syt' é é - pa
Vito te dua i - tha,
Vito, dote te marr. grua "

PYSH

Vitua u - turperua
Po me shum' u - idhenua
Dhé ju perghéq : — " S' jé per mua
Se u gne tjétere dua,
Jémi gne bés' é gne sua ;
Po mérré fjalene prape
Dhé shko ketéje mé vrape ! "
— Kush eshte me trim sé mua
Qe do te te marre grua ? —
— Ai qe jam vluare
Dhé per te martuare,
Eshte trim sa s' ghendéte,
I - mire sa s' benete ;
Ish vét' i tréte vela,
Kush ka qene si ata ?
Trima sa s' i - zinté plumbi !
Gnéri vdiq, i - dyti humbi ;
Jorghin é - la Pérendia
Shprése per memen' é - tia :
Esht' i - vétem é jétim

I - dashur' i shpyrtit im
Dhé nga te tere me trim :
Perdor palhen é andzare,
Esht' i - zoti te me marre !
Ndaj te lutém mos me nga,
Te mos biésh me hata.
Sé shéjtani pune s' ka ! —
Turku mé tetila fjale,
Qiti te shkrétene palhe !
Nga inati u - vérdhua
Dhé thirri po si dragua :
— N' eshte mi zoti nga une
Lé te me dale ketune !
Ne me munte, bésa - bése !
Burri yt po lé te jése ;
N' é dergofsha n' ate jéte,
Dié dote te marr véte ! —
Vitua shum' u - frikua,
Lot' i - vinine si krua,
Dhé me shtepi, duk' é qare,

Refëu ch' i kishtéj ghare.
Po Jorghi, kur é - ndeghoi,
Véshi armete dhé shkoi,
U - nghit malite perpjéte
Ashtu si nghiténe réte,
Dhé mé ze te math si shkembi
Po therrit sa tundéj vendi:
— Kush esht 'ai q 'u - levdua
Qe do te mundét mé mua ? —
Mé ze te math si ghemimi
Ju perghéq ahéré trimi:
— Une jam ai qe shtié
Dhé plumbi dem nuke bié . . .
U jam ai qe kam vrare
Béjtere dhé pashalare,
Dhé kaure mije véte
Kam derguar n' ate jéte !
Dhé dote trembém tani
Nga gne fusharak si ti ?
Tani dot' a shoch dhé véte

Kush eshte trim i - vertéte . . . —
Keto thosh Turku dhé vinté,
Po dhé Jorgua é - printé ;
Hodhi armete per - dhéze
Dhé zuri te sghéshe bréze
Qe kish qépur Vitua véte,
Si fustan ' é fémélété :
Kur é - kujtoi u - shemp,
Mos pandéni sé u - tremp ;
Beri kruqn, é fshiu lote,
Jam azer ! hidhét é thote,
Edhé me dore gne thike
Ju versul Turkut pa frike.
Trimi rrembéu andzare
Dhé po hidhéj si i - marre :
Fryti éra : nga rembimi
Leshon flokaténe trimi ;
Atjé ku qé aferuar
Mé ghosk hapet léshetuar,
Ju duk, ne gryke te ti,
Varture gne *hajmali*.

Jorghi kur pa hajmaline,
Syte permi te i - ngrine;
— Dalé, tha, ashtu me rruash,
Pa leftojme kur te duash!
Po ne béson Pérendine,
Kush t' a fali hajmaline? —
— Nenia ne foshgneri
M 'a vari per mbaresi. . .
Po ch 'te duéte kjo pune? —
— Gne te tilhe kam dhé une! .
Shuko! mema m' a - ka fale
Dhé mua, kur jéshe djale! —
Te dy trimat hapne ghite
Dhé shukonin hajmalite
Qépur mé pe te florite;
Si gnéra dhé tjétera,
Te dya te vjétera;
Per - mbrenda, pshélur mé karte,
Ghéne nga gne kruq te arte!
Mbéne te maniture
Dhé si te goditure! . .

BKSH

Te tilhe pune kur pane
U pushtuanne dhé rane
Dhé te dy gne fjale thane:
Te kam vela mor i - mjére!
Nga gne bark paskémi lére!
Jémi gne fis é gne fare,
Jéme te dy Shqipetare,
Po bésa na paska ndare
Sa na beri per te vrare!
Sot qe dime vétehéne,
Duéte te bejme béne
Te duame memedhéne.
Tani te marreme male,
Te leftojme per lirine,
Te mos kthénémi te ghalhe
Pa shpetuar Shqiperine!
Tani Viton ta harrojme,
Mé Turqine te leftojme,
T'a dergojme nga ka ardhe,
Te shome dite te bardhe.

Varferia dhé Liria.

Jam i - varfer po i - lire,
Ndaj me pelqén varferia ;
Kush do te rroje me mire
S ' urdhron dot vétén é - tia . .
Mbréti sikur te me thote :
" Hajdé ne Palas mé mua,
Te gezosh dhé ti ne bote, "
Dot ' i - thém, zot nuke dua :
Per te ngren' é per te pire
Nuke munt te shésh lirine,
I - varferi rron me mire
S' ai qe do madherine.
S' me duét érghendi mua,
Dua lirine dhé ndére,
Dua te bej si te dua,
Jo si te duan te tjére.
Kush munt é ben si do véte
Ben si thote Pérendia ;
Nuke ka ne kete jéte
Ghe m' é - vyér sé liria.

Fshati-im

Maléte mé gure,
Fusha mé bar shume,
Arate mé grure,
Me tutjé gne lume.

Fshati per karshi
Mé Kish' é mé varré,
Rotul tsa shtepi
Te vogela faré.

Ujete te ftote,
Era pun' é-madhé!
Bilbili ja thote . . .
Grate si zorkadhé.

Burrat ne ne hié
Lozen, kuvendojne,
Pika qe s'u-bié
Sé nga grate rrojne!

PKSH

Grate véne nd' are
Dhé ne vréshta grate,
Gruaja korr bare,
Punon dit é nate.

Grate ne te shire,
Ne te vjéla grate,
Ikine pa gdhire,
Kthénéne mé nate !

Gruja, per burre,
Dighéte ne diélh,
Punon é s' rri kurre
As diten é - diél !

O moj Shqipetarke
Qe vét' é ngét qéte
Edhé drék é darke
Kthénéj é - ben véte,

Moj é - mjéra grua
Ché do burre zine
Qe ftoét ne krua
Dhé ti mban shtepine !

BISH

Dhéu.

Dhéu i-ghat' é i-ghére
Na ép buk' é na ép vére
Per te ngren' é per te pire,
Kush di ta punoje mire.

Si gne gnéri i-shtrenguar,
Dhéu nuke fal ghe kurre:
Pa munduar, pa punuar
S' na ép as miser as grure.

Do ta punoje gnériu
Dhé ta vadije mé djérse
Qe ta haje buk' i-ziu,
Nga uria te mos vdése!

Punoni moré te mjére
Sé dhé gheri ne na mbéte,
Pas névé vine te tjére,
Nuke soséte kjo jéte.

BKSH

Aléksandri i-Math.

Aléksandr' i-Math qé burre
Mé te madhé trimeri,
Shqipetar qe s'ghendét kurre,
Po ch' beri per Shqiperi ?
Qe foshgne, duk' é leftuar
Zotoi te ter' Asine,
U-be gne mbrét i-levduar,
Po ch' beri per Shqiperine ?
Mé punera qe punoi
Mé trimeri qe rreféu,
Qe kur léu dhé sa rroi,
Ch' te mire pa Memedhéu ?
As gne te mire s' ka pare,

BKSH

Shqiperia mbét é-mjére . . .
Sé trimate Shqipetare
Leftojene per te tjére !
Punojene per Turqine,
Per te ndyrene Moré ;
Shqipetari, Shqiperine,
S' é-do, ben sikur s' é-gné !
Trima, te varfer, te pasur:
Shqiperin' é-kan' harruar :
Gnéri nuk' i-eshte qasur !
Per te gnéri s' ka punuar ! . .
Po ata vdiqne te tere,
Dhé Zoti lé t' i-ghukoje !
Te ghejne si kane bere . . .
Po Shqiperia te rroje !

BKSH

BKSH

PJÉS' É-DYTE:

DASHURIA.

BKSH

BKSH

Dashuria.

A !

Dote levdoj Dashurine
Mbarambar mé Pérendine
Sé Dashuri' é - vertéte
Na mban te - ghalhe ne jéte.

S' é kam ƒare Pérendine,
Sho nga hére Dashurine ;
Dashuria mbréteron
Sé gnériu pa te s' rron.

Tsine te bésoj tanine
Pérendine' a Dashurine ?
Pérendi ne kete jéte
Eshte Dashuria véte.

BASH

B !

Si per burra dhé per gra
Dashuria, Djaleria,
Jane si motr' é vela :
Si ndan dot as Pérendia,

I - riu mé dashuri
Rhon é gezon kete jéte,
Dhé pastaj ne pleqeri
I - rendonét jet' é - shkréte.

Djaleria qendron pak ;
Kshtu ka thene Pérendia,
Kur benet gnériu plak
S' i ka hié dashuria .

O ju te - ra é té - ri
Dot' u shkoje djaleria
Dhé bashke mé djaleri
Fluturon dhé dashuria.

BKSH

C !

Kur jéshme te-véghi, si molh' é pa bere
Puthéshim nga hére ditene te tere;
Vij' é te kerkoje, vij' é te therrése,
Lesnim te dy bashke, rronim mé gne shprése.
Mba ment sa te désha, mba ment sa me déshé ?
Mba ment si me thoshé évogel kur jéshé ?
Tani qe jam burre, tani q' u-madhové,
Dashurin' é pare psé valh' é harrové ?
Tani q' u-poq molha é-hane te tjére,
Mikn' é-djalerise s' é-qas as me dére !
Po, si ndjélhendushja vété ne vent tjéter
Dhé kthénéte prape ne folé te vjéter,
Ashtu zemra joté mundét te kujtoje
Mikn' é-djalerise dhé prape ta doje.

D !

Dighém, perveloném
Sé te dua shume,

Ditene méntoném,
Naten rri pa ghume.

Luléte te dinin
Miké, sa te dua,
Ketu dote vinin
Te qajne mé mua,

Zoqte te ndeghonin
Dot' me rrinin prane
Dhé dote kendonin
Te harroj sévdane.

As gnéri ne jéte
Plagen s' ma sheron
Perréch mikja véte
Qe vjén é - lendon !

E !

Bukuria joté, lésherat é - tua

BKSH

Po si pende korbi, te ghata m thua,
Balhete si diélh, faqéte si molhe,
Qafa jot' é ghate, mési yt i-holhe,
Sisete si shége, dhembet si thelpegne,
Buzet si bubuqé syte si geshtegne,
Dora si tebore, fjala joté mjalte,
Kurmi yt i-dérdhur, shtati yt i-nalte ;
Ghithe me kenaqin, te tera t' i dua,
Po zemera joté u be gur per mua ! . .

F !

Emba ment moj Mare
Dashurin' é-pare ?
Gnéri nuk' é-ghéghi
Sé jéshme te véghi.

Une pa ty s' rroje,
Vij' é te kerkoje,
Ti pa mua s' rrojé
Vij' é me kerkojé.

BKSH

Ne lulé mé ére
Puthéshim nga hére.
Dhé si burr'é grua
Losnim nene ftua.

Gne dite, te-dyza
Losnim *Mbyla-syza:*
U fshyém pa dukur
Ne férra, ne gure,
U fshém kaqe bukur
Sa s'u ghentm' dot kurre....

G!

O mœj lulja manushaqé
Ndegho dashurine ch' thote:
Te lozem faqé per faqé
Te na perziéne lote.

Ma do zemra, ma ka enda
Te lozem balhe per balhe,

BKSH

Sé zjarri qe qémi brenda
Na djék sikur te mos dale.

Te lozem gushe per gushe,
Bashke te vémi, te vime,
Po si shtjérrate ne fushe . . .
Sé te-ri ghithe-gne s'rrime.

H !

Kam dashure lulét, kondzén, trendafile,
Zoqte qe kendojne, thelezat, bilbile;
Tani s'me pelqéjne, me lene te ftote,
Sé dua gne chupe si henez é plote,
S' ka shoqé ne bote.

Kjo eshte per mua lulé trendafili.
Kondzé, manushaqé, theleza, bilbili.
Kur me shkon ne ruge, mé lulé me dore,
Léshrat prapa kravé hédhur si kurore,
E-bardhe si bore,

Me mirréne mente, nga syte vérboném
Dhé nga dashuria dighém, perveloném,
Si dighén ne zemer ghithe sa é-gnone,
Manitén te terre trimat kur é-shone,
Mashala! i-thone.

I !

Pika, pika bié shiu
Dhé tebora floke floke,
Vétetit é fryn vériu,
Brésheri kertsét mi toke!

Lé te fryje ér' é-ftote,
S' ka ch' me ben dimeri mua:
Dashuria me mban ngrote
Sé pushtoj ate qe dua.

Kur fryn éra mé talas,
Kur bié tebor' é shi,
Sa fle gnériu mé gas'
Kur ka mikéne ne ghi!

BKSH

Vajé

I !

Qe diten qe vdiqé, qe kur s' te kam pare,
Lote qe kam dérdhur s' me jane dhé thare ! . .
Shume vjét u bene, sot u mbushne dhjéte
Qe kur me ké léne dhé s' te sho nde jéte !
Nde ch' kopshe mé lulé ké qendruar valhe ?
S' te vjén kéq per mua ? s'te vjén malh per djalo ?
O Enghelh i - bukur mos meno ne bote,
Kthéu te te shome te na mbétén lote.
S' rrojme dot pa tyne, ti si rron pa névé ?
Motemot qe rrojtim bashke s' me - hurrévé.

BKSH

Atjé ték rri jane qipariz' é varré. . . .
Kthéu te te shome, mos na lé per faré!
Mos na lé te ghore, mé zemer te ngrire;
Kthéu te gezonésh kur te shoch te-bire:
E-ké lene foshgne, tani u-be burre;
S' harrité t' a rritjé, s' te ka pare kurre!
Per ty, shume hére, choch' do te me thote,
Po s' munt t' i-perghighém sé me mbytin lote!
Kthéj koken me gn' ane dhé veshtroj perpjéte. . .
Duké pshéretitur, té Zot' i-vertéte.
O Zot i-vertéte, st' érdhi kéq per djale
Kur i-moré memen dhé me lé te ghalhe?
Te me késhé marre dote qé me mire,
Dhé te rronté mema te rritéj te bire.
Mé sé rrojne foshgnat? ch' i-rrit chilimite?
Dashuri é memes dhé perkedhélite.
O Zot, te jam fale, mos me lé te-mjére:
Dergom' Efghénine t' a sho dhé gne hére.
— « Psé s' kuvendon mire, moré pune-bardhe?
« Tsilhi vdiq gne hére dhé prape ka ardhe?

« Ghith' humbasen gruan, memen a babane,
« Po ata qe mbétén, si ti nuke qane :
« Te vdékurin lote s' é - bién ne jéte,
« Po lutu dhé falu te rrich djalen véte » —

Dojé drit' o Qiélh, moré driten timé,
Dhé me mbushé jéten plot mé hidherimé ! . .
Tani rroj pa shprése, ndaj s' dua te rroj,
Sé dhé Pérendine tani s' é - bésoj ! . .

II

Diten é vitite pare
U be qiamét - i math,
Nga tebora qe ka rare
Faqéz é - dhéut u - sbarth.
Tsingerrim' é érretsire,
Jashte vériu pelhét !
Bié bor ' é brésherire,
Dhéu dukéte si dét !

BKSH

Eshte nate, nat' é zise . . ,
Vétetit édhé ghemon !
Gne Enghel i - Pérendise
Dérghét sermur' é renkon !
Ka tri dit qe po mundonét
Dhé mé vdékijne qerton,
Po vdékja s' do te mergonét
Sé shpyrtin' é - saj kerkon !
« Pérendi, léme te - ghalhe
— Po lutéte mem' é - mjére —
« Te munt te rrit kete djale,
« S' ka gne jave qe ka lére.
« Kush dot' a marre ta rrije ?
« Jétimi qysh dote rroje ?
« Kush doti ape te pije ?
« Si une kush dota doje ?
« Kush dota doje Stéfane !
« Me ndjé o Zot i - vertéte !
« Sé Stéfani ka babane,
« Dhé dota rritije véte. »

BKSH

Engheli mé keto fjale.
Nga jét' é-rremé shpetoi,
La baban' é-zi mé djale!
Dhé nde Qiélh fluturoi!

III

Bote, moj Bot' é-pa-bése
Nuke ké ghe te vertéte:
Gnériu po dote vdése
Dhé nuke vjén me ne jéte.

Dote gdhiéte gne dite,
Dote vije gne menghés
Nuke dote sho te-mite:
Dote mbyl syte te vdés!

Dote qajn' é te-vajtojne,
Dot' me mbulojne mé gure,
Pastaj dote me harrojne
Dhé si-kur s' kam qene kurre!

BKSH

IV

Kur shkoj ne per varrë kuka mbire bari
Qe rritét' é maét mé trupine tene,
Kujtoj kush ka vdékur, méntoj ch' kane qene,
Zemra me lendonét dhé s' pùshon se qari.

Ghithe kane qene te - ghalhe si une,
Te - varfer, te - pasur, te - urt' á te - marre,
Mbasé kane dashur, qéshur' apo qare,
Po te tere vdiqne dhé ne var ri - vùne !

U lutém moj éshtra te kujt ini valhe ?
Edhé kurm' i - bukur ch' u - be, ku é - late ?
— Kujto djalerine . . . gne Enghelh, gne nate
T' iku ne per duar dhé te - la mé djale . —

BKSH

Zoléjka.

Nga ghithe vendét, Misiri,
Ka qen' é eshte m' i - miri :
Ghithe mone jéshil bari ;
S' ka te sosure béhari . . .
Pém' é lulé ghithe moti !
E - ka békuare Zoti .
Piramidhéte mé diélh,
Kane kokene ne Qiélh .
Budgit Nili mat' é dite,
Bié uje te florite . . .
Vadit fushene te tere
Nuke ka vent te mes zere.
Ujitén dhé hurmadhjéte

PKSH

Dhé véne, véne perpjéte,
Vériu s' réshtéte kurre
Kur ze é lot mé pelhure,
Mbane Nilit pune - mbare
Ka qene *Tani*, me pare,
Ka qene kryé - qytéti
Sé ketu kish frone mbréti.
Tani, ka qene qne hére
Qytét i - math é i - ghére;
Ne més te keti Qytétit
Ka qene Palas' i - Mbrétit
Sé ne kete qytét rroi
Apofi, kur mbréteroi.
Prane mbrétit, nga vériu,
Rrinté Zoti Pétéfriu,
I - ndéruar nde Misir
Sé mbréti é - kish vézir.
Mendjé - math é zemer - mire
Kishté ne dore Misire:
Pétéfriu mbréteronté

BKSH

Sé Apofi shum' é donté ;
Apofi mé Pétéfrine
Bashke rrine, han ' é pine . . .

Pétéfriu u martua
Mori Zoléjkene grua.
Moj Zoléjke, nga ké dale
Qé ké diélhin ne balhe ?
Zoléjke kush te ka bere
Qe maniténe te tere ?
Te ka bere Zoti véte,
Nuke ké shoqé ne jéte !
Kush pa bukurine tendé
Dhé nuke lojti nga mendé ?
Kur do Zoléjka te dale
Mé karotse ja mé kale,
Vétem a mé Pétéfrine,
Ysméqarkat pas i - vine ;
Kur dél Zoléjka mérr ére
Dalen dhé shume te tjére,

PASH

Nuke rri gnéri pa dale ;
Kush ta shoje me ne balhe !

Zoléjka rri é méntuar
Dhé ve kokene ne duar . . .
Ysméqarkate s' gudzojne
Te lozen é te kendojne.
Ch' ka Zoléjka qe s'gezon ?
Zogne si ajo kush rron ?
Kush ka te tila te mira ?
Kush ka ghera te pa vdira ?
Kush ka burre me te mire ?
Burr' i - saj urdhron Misire ! . . .
Dashuri moj dashurri !
S' péshon érghent é flori ! . . .
Sa para ben madheria ?
Nuke bliét dashuria.
Duro Pétéfri, duro !
Zoléjka nuke te do ! . . .

BKSH

Apofi, mbrét' i Misirit
I - tha gne dite vézirit :
Per gha sivjét s' kémi vate.
Po te vémi kete nate,
Sé diten ben shume vape ;
Ne menghés kthénémi prape.
Mbréti keto fjalé foli :
Pétéfriu jashte dolhi,
Ysmétsin' é - ti kerkoi
Té Zoléjka é - dergoi
T' i - thote te mos a prése.
Ne pézul te péndzérése
Rrij Zoléjka, si nga hére,
Kur pa Josifne me dére.
Nuke qé gnezét vjéch djale,
Mustaqja s' i - kish dhé dale ;
Ish i - bukure si chupe
Dhé per te pire ne kupe.
Arapinkate kendonin,
Zoléjkene perghezonin.

— Zogne, me dergoi Zoti
Pététriu fuqi - ploti
Kete nate mos é - prini
Vétem te hani te pini:
Per gha sonté dote véne
Qe te dy bashke mé mbréne. —
Keto tha djali dhé priti,
Po Zoléjka pshéretiti:
— Psé mban kokene me gn' ane ?
Qasu te rrish ketu prane,
Dhé Pététriu mé mbréne
Ku te duan lé te véne.
Ti te rrish sonté mé mua,
Josif dié qe te dua !
Te dua, te dua shume !
Dhé gdhij natene pas ghume . . . .
Qe ditene qe te pashe
Zemerne timé t' a - dhashe.
Dalé te te puth gne hére !
Kete nate mos me lére

BKSH

Véteme mé ysméqare,
Josif benu djal' i - mbare ! . . .
Ea te rrish ketu prane,
Kuvendome per babane,
Per memen qe te ka bere
Dhé per gnérst' é - tu te tere.
Psé ké lene Memedhéne ?
Kush te shiti, kute ghéne ?
Psé érdhé zuré Misire ? —
— Jéshe toshgne, s' mba ment mire . . .
Po vélezrét qe kam pasur
Si vela s' me kane dashur,
Dhé me shitne per te hola ! . . .
— Faqja joté posi mola,
Goja joté si qirshia,
S' te chmonéte bukuria ! . .
Te dua, Josif, te dua !
Sonté dote rrish mé mua;
Dote ham' é dote pime,
Te dy vétem dote rrime ! . .

Sé eshte jona kjo nate,
Zoti é befte te ghate!
Zoq é bilbile, kendoni,
Kur te gdhiét te na zghoni . . .
Mos ki turp, mos u bɔn djale. —
— Zogne, Zogne, te jam fale!
Jam rob' i - Zotrise suaj;
Kato fjale mos m' i - thuaj! . . .
Jétim i - shkréte, fat - ziu,
Me ka blére Pététriu,
Si baba me eshte sjélhe,
Me ka rriture si pjélhe,
Me ka mbajture mé shprése;
S' gudzoj t' i - dal i - pa - bése! . .
— Nga burri im mos ki frike:
Mbaj mé vété kete thike,
Prapa dérese te fshiésh
Dhé kur te vije t' i - biésh! . .
Vraé Pétéfrine véte!
Pastaj te me késh per jéte . . .

O Josfi, mos u - largo !
Josif, Zoléjka te do !
Rri mé mua kete nate . . .
Nuke jam si ghithe grate :
Ghithe trimate me duan,
Mbréti per mua le gruan ;
Po si ty s' dua te tjére.
Léme te te puth gne hére ! —
Edhé é - puthi sa déshi.
Josifi u - ngré nga shéshi,
I - mjéri kerkon te dale . . .
Zoléjka ju nghit si nghale.
Uzemerua sa qau !
Dhé zu Josifne nga krau !
Ky é - shtyti mé te forte
Dhé dolhi jashte me porte.
Zoléjka mbét turperuar
Mé sakon é - ti ne duar :
(Josifi, qe ta leshoje,
Qiti sakon te shpetoje) .

BKSH

Dita s' qé dhé gdhire mire,
Zoléjka si égertsire
Nga inati qe kish marre
Priti burren duk é qare !
Ch' ké qe qa o shpyrt, i - thote
Dhé vaté t' i - fshije lote
Po Zoléjka qa me shume.
— Ku me lé vétem' o lume ?
Iké me lé mé te tjére . . .
Josifi me prishi ndére ?
Erdhi naten te me zere
Dhé ra mé mua te flere !
Dote me kish turperuar
Si kur te mos jéshe zghuar !
Te mos késhe kete thike . . . .
Kur é - pa i - érdhi friko
Dhé hapi déren é shkoi
Po sakon ketu harroi ! —
Kur ndeghoi Pétéfriu
Ghithe keto fjale, ngriu;

BVSH

Kur pa dhé sakon é - tia
I érdhi rrotul shtepia :
Zoléjken te turperoje
Josifi ? . . tani te shoje . . .
Dhé urdheroi t' a - zene,
Nbrenda ne budrum t' a - vene !

Kopshti i - Dashurise.

O Pelumb' i - shkruar
Dot' te marr ne duar
Dhé duk' é kenduar
Ghétke dot' te shpié :

Ne gne vent t' uruar
Dhé te lulezuar

BKSH

Ne uj' te kuluar
Edhé nene hié;

Afer ték gne lume
Ku ka lulé shume
Te biém ne ghume;
Hena te na ndrije;

Yjte te shukojne,
Zoqte te kendojne
Edhé te na zghojne
Dita kur te vije.

Pa ngren' é pa pire
S' mbétémi. moj Mire,
Sé u ndaj te gdhire
Dergoj é na sjélhin:

Qumeshte te dhire
Dhé djathe te mire

BKSH

Pa uj' é pa hirre,
Dhé rrush kur te vjélin;

Ngʰale ngʰa Janina,
Mjalte ngʰa Kanina,
Vére ngʰa Voshtina,
Uje ngʰa Sopoti;

Molhe ngʰa Horia,
Mish ngʰa dhent' é-mia,
Désh ngʰa Laberia
Na é falte Zoti.



PLAKU.

Moj miké ch' eshte kjo pune?
U plaksh' é nuke me gné!

BKSH

Kur te benésh ti sa une
Nuke dote jésh si jé.

Gnéri s' ka mbéture djale,
Dot' a humpsh dhé ti te-rite:
Vijate qe kam ne balhe
Dot' i késh dhé ti gne dite.

Kur me shukon, mos mbyl syne
Dhé mos qésh mé pléqerine:
Kam qene dhé u si tyne,
Si u dot' benésh dhé tine.

U plakshe si dhé te tjére;
Pléqeria s' ka te share:
Nga ti me pare kame lére
Pandaj u plakshe me pare.

Punete vine mé radhe
Si ch' do ghe ne kete jéte:

BKSH

Sot une kam lésh te bardhe,
Néser dot' i késh dhé véte.

Po mé ghithe pléqerine
Kam dhé u lézét ne bote ;
Sé ne ké ti bukurine
Une kam zemer te ngrote.

Mos harro ashtu me rruash
Sé dhé pléqte kane ghak . . .
Ndaj te lutém te me duash;
Nuke jam dhé shume plak:

Me dukéte sé jam djale,
Sé s' ka pléqeri per mua,
Dhé shpyrti kur te me dale
Moj miké, dote te dua.

BKSH

Nyja Tri. . . .

Tri kane qene Bukurite:
Frosina, Talia, Aglai,
Tri jane dhé sot Pérendite:
Fruma, i-Biri dhé Babai.

Tri ghera bukuri é thjéshte
Te zéza duéte ti kéte:
Vétulate, Syte dhé Léshte,
Qe te na pelqéje per jéte.

Tri ghera te kuqa te jéne:
Faqéte, Buzete dhé ghua;
Keto reléjene shendéne
Dhé bukurine ték gne grua.

Tri te-tjéra te bardha shume:
Tsipa, Thojte, Dhemb' é dhembalhe,

BKSH

Qe - lene trimate pa ghume
Edhé mendjén é - bejne dhalhe.

Tri ghera te trasha, te plota:
Lhera, Chapoku édhé Ghiri,
Bejne qe maniténe bota
Edhé lozine nga fiqiri.

Tri ghera te - ghata i - dua:
Keto jane Qafa dhé Shtati
Dhé Pléksidhate nghér me thua.
Mjér' ajo grua qe s' i - pati

Tri ghera te vogla kur jane:
Versa dhé kembete mé duar,
Fat - miroshé grate q' i - kane,
Bukuria s' u - ka te ts' muar.

Tri ghera mbéténe te tjéra;
Ghosku, Turiri édhé Balhi

BKSH

Duéte te jéne te ghéra
Sé perto me ka marre malhi.

Tri te ngushta te kéte femra;
Goja, Mési dhé. . . . cho te jéte
E-tréta ghe qe m'a-do zemra?
S'é-thém dot po ghenjéni véte.

Kasapi.

Pyéta gne dite
Kasap ghaketore
Qe thér baketite,
Mé thike me dore. . . .

O kasap o djale
Thér qenqne ne balhe

BKSH

Dhé délén é - mjére
Lé per tjéter hére.

« Jam kasap, me thote
Duké fshire lote,
Po jam zemer - mire
Sé s' jam égertsire ;

Qenghite, ne balhe,
Thikene s' ja héq :
Sé délja é - ka djale
Dot' i - vije kéq.

S' eshte pun' é - dréqte
Dhé per baketite
Te rrojne pléqte
Te vdésen te - rite. »

Dhé kasap' i - zi
Ka zemer te bardhe,

BKSH

Po ti Pérendi
Psé s' punon mé radhe ?

O Zot, te jam falc,
Po nuke ben mire :
Le memen te - ghalhe
Dhé i - mér te bire !

Fyélh' i Bariut.

Bariu, shoke, bariu,
Kur ghemon é fryn vériu,
Eshte perjashta fat - ziu,
E - rré brésheri dhé shiu !
Barine, shoke, barine,
Mos é - harroni fat - zine.
Sé le gruan é shtepine,
T' u kulose baketine.
Kuloni moj baketi,
ti, ti, ti . . .

BKSH

Kuloni biro kuloni,
Kur te vdés te me kujtoni,
Ndjése paste te me thoni.

Shukoni barin ' é - ghore :
Ne diélh a ne tebore,
Bariu, mé shkop ne dore,
Ruan déshte mé kembore.
Veshtronjé barine mire,
Mé te gren ' é mé te pire,
T ' u marre dhente pa gdhire
T ' i kulose mé deshire,
Te rrije bashke mé to,
to, to, to . .
Hani moj baketi, hani,
Kur te vdés dote me qani,
Per mua zi dote mbani !

BKSH

* DESHIRE.

I.

Kush lé mikéne qe ka
Edhé ndaéte mé shoké
Per te fituar para!
Nuk' i-ka mente ne koke...
Ikeni moré te mjére,
Iqni Déti ték t' u-nzjére,
Sé per mua, dashuria,
Ara, veshti dhé shtepia
Me bejne te rroj mé gas,
Sé s' dua te le ghe pas.
S' dua t' iki si perpapa,

---

* Nota: Shumc nga keto vjérsha jane shqiperuar nga Vjérshetori Latin « Tibuli »

BKSH

Dua te rroj ne per ara,
Mikja prane te me kéte;
Te punoj arate véte.
Fat - mirosh! mot é nga mot
Grur' é miser te kém plot,
Te kém raki, te kém vére
Te embele si shilqére.
Te véte mé baketi,
Mé qé, mé dhen é mé dhi,
Dhé t' i - shpié reze malit
Te hane majen é barit,
Dhé kur te pjélhe gne dhi
Dot' i ve kétsne ne ghi.
Nuk' iki nga Shqiperia
Si punojn' ata qe s' dine;
Mos é dhente Pérendia
Te ndaém mé dashurine:
Sa te munt te rroj mé pak
Po ketu te beném plak;
Dhé ne vuaj, lé te vuaj,

PKSH

Te mos vdés ne vent te huaj!
Te sho memen é babane,
Te kém dhé motrate prane,
Dhé kur te vdés te me qane
Pas zakonéte qe kane:
Te me marrene ne duar,
Te qajne mé lésh leshuar,
Dhé mikia kur te vije
Te qaj' é te ulerije!

II.

Ku jane vaftét é pare?
Streghyshrét sa mire qéne!
Shkonin jétene pa ndare
Edhé dojnin Memedhéne.
S' kish pampor é s' kish ghémi;
Nuke vinin te fitonin,
Atdhéne s' é-lij gnéri,
Po punonin édhé shkonin.

BKSH

Kau nuke kishté zghédhe,
As fre per kalen é - forte . . .
Dhé si s' kish gnéri te vjédhe
Shtepite qéne pa porte . . .
Arate s' kishne sinuar,
S' kish te pasur é te varfer.
Dhéu qé i - lulezuar,
Kafsh' é gnérs rronin te ater . . .
Nuke kishté gnérs te liq,
Sé lufta s' kishté dhé dale,
Ghithe bota qéne miq,
Qéne velézer ne balhe . . . .
Po tani, Zot ' i - Vertéte,
Gnériu ghan mé arine !
Nuke hiqéte kjo jéte
Sé gnériu ha gnérine ! . .
Sot s' mbréteron dashuria ;
Nuke kémi dashuri ;
S' na mbéti as trimeria ;
Sot rrojme ne roberi !

III.

Sot é tutjé, me shtepi,
Mikia te mbréteroje,
Tsili do nga miqt' é - mi
Per zogne duét t'-a gnoje.
Kur te vété ne per ara,
Kur te korr é kur te mbjélh,
Te kém mikéne perpara
Kur te shij é kur te vjél.
Dhé ne stan kur te me shoje
Mé qé, mé dhen é mé dhi,
Mikia t' i - numuroje
Sé mos m' i - vjédhe gnéri.
Te me zbukuroje stane.
Te beje djathe te bute,
T'u - hédhe qenét te hane
Te na ruajn' nga hajdute.
Edhé nata kur te vije,
Te marr mikéne ne ghi . .
Dhé heneza te na ndrije
Dhé te na kéte zili!

BKSH

IV.

O shoke, ch' u - prish dynaja,
Si per burra dhé per gra ;
Tani shitéte sévdaja . . .
Mjér' ai qe s'ka para.
I - pasur, te palhte varri !
Ti qe blévé dashurine
Dhé nuk' é - lé si me pari,
Te marte Djalhi shpyrtine !
Ndeghoni moré te ri,
Ndeghoni dhé ju te ra :
Duani ate qe di,
Jo ate qe ka para.
Duani dhé vjérshetore
Mbarambar mé Pérendine,
Sé rri mé lulé me dore
Edhé kendon Dashurine.
Ata qe jane levduar
Mé kenge, nga vjérshetori,
Jane burra te ndeghuar

BKSH

Dhé rrojene sa Tomorri!
O ju te ra é te ri
U lutém te me kendoni
Qe te kini dashuri;
Kur te vdés te me kujtoni.

V.

Moj miké kam bere bé
Te marr syt' é-mi te shkoj,
Sé mé nazéte qe ké
Mé ty nuke munt te rroj!
Nuke te bera faj kurre,
Ghe te lige s'te kam bere;
Dhé kur jéshé é-semure
S'me zinté ghumi te flere!
Lutéshe té Pérendia
Mé métani dit' é-nate,
Te t'ape nga dit' é-mia,
Te késh jétene te ghate.

BKSH

Qysh te bej moré te mjére !
Qe ditene q' u sherua,
Mikja zuri miq te tjére !
Edhé lot é qésh mé mua !
Gne dit ' iku é me la
Sé do gne qe ka para.
Nalét pach moj Dashuri
Sé me tréte si qiri.
Dua te déjém mé vére
Te munt te harroj qédére,
Dhé te ze miké te ra,
Te me lene si me la . . .
Po as véra s' me ze kurre
As mé miké s ' beném burre . .
Dhé me thone, mé meri :
Te kane bere maghi !
— S ' me zene maghite mua,
Po kujtoj ate qe dua. —

BKSH

VI.

Miké psé me prish fiqire ?
Véte vijé me kerkojé . . .
Tani ku ghété, me mire ?
Psé s'me thoshé kur s'me dojé ?
Me thuaj qe me do shume.
Po jane fjale te rremé :
Iken é me le ne ghume,
Edhé me punon lagemé !
Ghithe - gne me turperon,
Dhé me pervelon si zjar !
Dhé te ligat qe punon
Gudzon é m'i - ze niqar !
Mjér'ai qe te ka grua !
Nalét paste kush t'a dha !
Sé dot'a gegnésh si mua,
Mé tértipé te mbedha.
Mos é - bésoni ch'u - thote :
Gruaja nuke ka bése ;
Dashurin'é - ka per bote

BKSH

Qe kur lén é sa te vdése!
Kush nuk' esht' i - zoti véte
Te rroje gruan qe mérr,
Kurre grua te mos kéte
Ne do te rroje mé ndér.
Qerto' thirre sa te duash
Gruaja s' é - prish qédére:
Sa me shume do t' a ruash
Aqe shume do te tjére!
Keto benéne ne bote:
Burrat qe rrojne nga grate
Sé nuke jane te zote,
Turperonén dit' é nate....
Te pyéni dhé te tjére
Po te mos bésoni mua:
Shini Adhamutn' é - mjére
Sé ch' héq, fat - ziu, mé grua!
Sos qirine dot' i - mbaje!
Sos te shara te duroje!
Sé s' ka, i - ghori, te haje;
S' esht' i - zoti te punoje!

VII.

Moj miké, kush te gegnéu
Dhé te shiti a te bléu;
Ay qe te ghéti burre
Mos pafte te mire kurre.
Semundj' é - madhé t' a zere;
Te mos mundij dot te flere;
Ghithe naten t' enderrije;
Te mos haj' é te mos pije ;
Uqrét é qente t' a hane;
Te shoje lugat babane !
Tetila ka per te vuar
Ay qe na ka trazuar .

VIII

Ata qe me kane share
Per dashurine qe kam,
Jane ghithe gnérs te marre
Sé i - pari nuke jam .

BKSH

Kush qésh mé halét é mia,
Qésendis mé dashurine,
T' a gheje nga Perendia,
Ch' kane mé mua fat zine !
Mé égertsira te rroje;
Tisifoni mé Sérbére,
Dit' é nate t' a mundoje,
Te mos shoje drit' é ére ;
Zot, te vdése nga uria,
Per uje t' a marre malhi,
T' i - zuritét mushkeria,
T' a pesoje si Tantali ! . . .

IX.

Dote pi raki dhé vére
Te munt te harroſ qédére;
Te harroj halét é - mia
Sé plasa nga dashuria,
Sé dhé mikia qe dua
Mbylh porten dhé qésh mé mua !

BKSH

O moj porte moj é - shkréte
Mos rri mbylture per jéte;
Hapu per mua gne nate
Moj te chafte gne sepate!
Hapu moj porte gne hére
Sé bié shi é fryn ére!...
Shtepia prapa té fiku,
Dél miké sé te do miku;
Moj psé s' dél apo s' te lene?
Sos jé molhe per te ngrene!
Moj miké moj jéte ghate
Gdhiu mé mikne gne nate.
Psé s' guzon te dalch té déra
Si bejne shoqét é tjéra?
Pyét te rit' é te rate
Ch' punojne, moj jéte ghate:
Chupa, mé tértipé shume
Le memen' é - saj ne ghume
Dhé hap dérene nga - dalé
Te véje te loze valhé;

BKSH

Dhé gruaja qe ka burre
Shtiréte me te semure,
Dhé kur benéte me mire
Ryn me shtepi ndaj te gdhire.
Ea, sa jémi te ghalhe,
Te lozem balhe per balhe,
Te duémi mé te forte
Sé kémi vdékijn' me porte.
Ea sa jémi te ri
Sé kémi dhé pléqeri:
Kur benén léshte tebore
Dhé dashuria héq dore . . . .
Vajza humbét bukurine
— Bukurine qe ké véte —
Dhé djali humbét fuqine,
Kur zen' é shkojene vjéte.
Zot i - Math é i - Vertéte,
Mendja joté nuke diét:
Djaleria shkon per jéte
Dhé gharperi perteriét! . . .

BKSH

X.

Kur te vije dhé per mua
Dit' é fundit, miké dua
Te vdés ne duar te tua :
Kur te me shukosh te vdékur
Dote qash sé s' jé nga hékur,
Sé s' jémi me per te pjékur !
Kur te me bejene varre
Dote me puch duk é qare
Sé s' jémi me per te pare ! .
Dote me qash moj é - mjére
Sé s' piqémi tjéter hére !
Dot' me qajne dhé te tjére,
Sé kendova dashurine,
Kendova dhé Trimerine
Memedhén' é Pérendine .

XI

Moj miké te bej porsi
Véteme mua te duash ;

PASH

Mos te gegnéje gnéri
Po ndérine tend te ruash.
Mérr gne plake nga mehala
Te te ruaje nga hére
Dhé te te thote perrala
Mé kandilé duk' é tjérre.
Dhé ghumi kur te te marre
Mbaé plaken me shtepi,
Shuaj lhamden édhé zjarre,
Dhé véteme bjér' é fli.
Ne menghés duk' é ketsyér
Te vi véte te te zghoj;
Kur te me shoch pa pandyér
Te me lesh te te pushtoj.

XII.

Ghithe naten é vadése
Fryntéj ér' é binté vése;
Dére - ziu po te prése
Ne pézul te pénzérése,

Ma beré mé te pa bése;
Dhé kur dha Zoti menghése
Usemurch' é doj' te vdése
Sé nuke rroj dot pá shprése.
Ch' me duéte jéta mua
Kur s' me do ajo qe dua
Lésh - vérdha nghére me thua,
Tsitsate po si lémua.
Ch' te kendoj per te me pare?
Dhembete margaritare,
Buza si qirshi é - kuqé,
Goj' é saj po si bubuqé;
Sy - zéz' é vétulhe holhe,
Faqéte si koqé molhe,
Més' i - saj si rréth unazé
Me loth é me vrét mé nazé.

XIII.

Te me ben Zoti dhé mua
Gne profit, gne noitua

BKSH

Qe te dije ment' é - tua :
Valhe me do sa te dua ;
Sé mé goje s' me thé kurre
Me do as s' me do per burre.
I - ziu jam i - semure,
Me dighét koka si furre !
Sé nga dashuri é - shume
Nat' é dite rri pa ghume.

XIV.

Zeri qan, shpyrti renkon,
Zemera katran kulon . . . .
Psé moj miké me mundon
Psé hugn kokene kur shkon
Dhé ben si kur s' me shukon ?
O mor i - ziu Andon
Psé vajton é psé kendon ?
Mikja zene s' ta ndeghon,
Dhé n' é - ndeghon s' te béson .
Nga te te besoj' é mjéra
Kur ndeghon fjale te tjéra ?

BKSH

BKSH

XV.

Babai nalét te kéte
Qe s' te martoi dot véte,
Dhé nenés i - palhte varri.
Qe s' te vloi me se pari.

Ch' é do jéten édhé ghene
Kur s' ké burre per te qene ?
Ch' te duéte gher' i - shkréte
Kur s' é trashegon dot véte ?

Ghene qe te la babai
Dote ta haje dzadzai
Sé dzadzai me kunane
Pra ndaj te dhane chobane,

XVI.

Me qafe te paste kush te ka martuar :
Mé burren qe moré nuke ké te shkuar,

BKSH

Jétimé, kur humbé memen é babane
Te vune ne dore motra mé kunane! . .
Motra tu be bushtre moj é - mjéra Rine,
Dhé burre per jéte te dhane éfghine!
Mir ata t' a dhane po ti qysh é déshé?
Qysh é moré burre? é vogele s' jéshé.

XVII.

Ne mos kupetové
Motra ch' te punoi
Psé nuke kujtové
Zotne q' é vérboi?

Ditenne q' u vlové
Mé kete zuzar
Nuk' é kupetové
Qe s' qé Shqipetar?

Kur moré éfghine
E - vuré nde ghi
Nuk' i - pé turine
Si thinghil i - zi?

BKSH

PJÉS' É-TRÉTE:

PERRALHA TE VERTÉTA

dhé te rremé.

BKSH

BKSH

MISIRI.

Fushe dhé fushe, dhé fushe prape
Fush'é pa sosur dhé shume vape.
Mal s'te shé syri, as brék, as gure,
Po ghithe mone tym'é pelhure;
Miza dhé pléshta dhé morra shume,
Kunup'i-shkréte te le pa ghume.
Era é ngrote, ujete trumbul;
Fiku mé ghemba, pjépri si kungul.
Perregn s'ka faré, vétem gne lume,
I-math si déti, mbulon mé shkume
Fushen te tere, ghithe Misire.

PKSH

Chupe pa prishur, burre pa brire. . . .
Nuk' i - ngre vendi! . . O vend i - mbare,
Vend per hajdute dhé per béqare!
Te ka békuar vét' Pérendia:
Ne mot dy hére pjélh baketia;
Dhé grat' é - mjéra s' humbasen kone:
Pjélhen é mbarsén pa zene mone!
Arate s' réshtén, i - vadit Nili;
Ték korrét gruri, mbilhét trifili,
Elbi dhé misri, thékra, pambuku,
Dhé dem é kote s' mundonét bujku.
Qéte si buaj, qeni si ujku.
Pylh s' shé dot kurre, as ré ne Qiélh;
Fshatrate dz' véshur dighen ne diélh.
Udhet plot tsuna, Koshet plot mjalte,
Shtepit' kasolé bere mé balte,
Lyér mé bajga brenda dhé jashte,
Jane mbuluar mé dru dhé kashte.
Kuaj te mire dhé te levduar,
Gomare shume dhé te ndeghuar.

Gnérste te vérber nga te dy syte,
Burrat pa lare, shume te ndyte;
Grate te zéshka, biéne ére,
Si buk é djathe é hane ndére. . . .
Si kundre thone ata q'i-dine,
Shume te spéjta per dashurine;
Din'é kenaqin, po te pa bésa. . . .
Ketu s'ka bore, shiu si vésa;
Béhari furre, dimri si véra;
Bashke kulosin dhente mé dérra.
Shume te pasur é te pa pune
Ne dimer vine rrine ketune.
Ne per qytété, nga Minaréte
Hodzet pelhasen mé ze si qéte.
Gnérste bétonén per Muhaméne
Dhé kur i falén puthine dhéne!
Udhete shtruar mé gur si shtufe;
Gnérzite véne, vine si tufe,
Z'bathur é z'véshur dhé te ngarkuar
Po paresia m'umbrélh ne duar,

Dhé grat' é - tyré dalen mbuluar.
Vdés gnéri ? Grate zen' é vajtojne,
Qajn' ulerijne sikur kendojne.
Ketu ka prinsé dhé pashalare,
Béjlér me téper sé nga gomare,
Te pasur shume sa s' dine, ch' kane
Po me te shumet s' kane te hane.
Permi te ghithe gne *Eféndine*
Qévésis vende nene Angline.

1 Krishteri dhé Chifuti

I Krishteri. Si ketu dhé n' ate jéte
Bésa jon' esht' é - vertéte,
E ka bere Krishti véte.

Chifuti Chifute Krishtin s' é - dine,
Bésojene Pérendine,

BKSH

Si perpara dhé tanine.

I krishteri. Krishti eshte Pérendia.

Chifuti E polhi zogna Maria.

I krishteri. Mé Frumen é Shenteruar.

Chifuti. Mé Josifne qé martuar.

I krishteri. Eshte djal' i-Pérendise.

Chifuti. I biri zognes Marise.

I krishteri. Punerate qe punoi,
Ujete q'é béri vére,
Te semuret qe sheroi;
Lazar'é shume te tjére
Qe ka nghalur preseri,
S'é rreféjne Pérendi?
Mé ghithe keto chudi
Qe beri Krishti ne jéte,
Si é pate dhé ju véte,
O milét i-malekuar,
Nuke qé per te besuar?

Chifuti. O kaur'o koke thate,
Bésonjé ju qe s'é-pate! . .

BKSH

Sé ata q'é kishne pare
S'é bésuan po é varre;

I krishteri. Nga dashuria per né
Nuke zebriti per-dhé?
Nuke hoqi, nuke voi?
Nga é-liga s'na mergoi?
Nga Shéjtani s'na shpetoi?

Chifuti. Psé s'u shpeton nga Turqia
Q'u ben kaqe te keqia?
Sé ahéré tok mé ju
Dot'a bésoj'édhé u!..

BKSH

Kurbéti.

Mitrua, kur u martua
Ndegni gne muaj mé grua!
Erdhi dita per te ndare
Dhé u ndane duk'é qare!
Gruaja qenkéj mé barre
Dhé kur polhi, beri djale.
Po Mitrua ku ish valhe?
Mote-mot qe qé larguar
Gne karte s'i kish derguar!
Ku t'i-shkruaj mem'é-mjére
Per djalene qe kish lére?
Tri vjét, katre, dhjéte shkruan!
Mitrua harroi gruan!
E-vartera sé ch'pesoi,
Te rite vétem é-shkoi!
Ch'é-déshi te tilhe burre
Qe s'é pati prane kurre!

PKSH

Ghithe bota vén'é vine;
Mitrua harroj shtepine!
Nuk'é di qe ka dhé djalhe!
Rron a ka vdékure valhe?
Keto thosh grua é-mjére,
Po burrit i-nbajti ndére.
E-zéza grua sé ch'hoqi!
Humbi shprésen ték i-shoqi;
Kur pa ngren'é kur pa pire,
Punoj'é rriti te bire.

Kurbéti, shoke, kurbéti!
Kush vaté é nuke mbéti?
Mitrua zuri Misire.
Po puna s'-vinté mire.
Qysh te véje puna mbare
Per te zéste Shqipetare?
Shkrétojene Memedhéne,
Ték pérndon diélhi véne!
Ku vini moré te mjére?

BKSH

Sé sot s' eshte si gne hére:
Qysh vini ne vent te huaj
Kur s' dini as g'hune tuaj ?
Lum kush rron ne vend te ti,
Mé qé, mé dhen é mé dhi. . .
Mos u - ndani nga Shtepia
Te mos mpshoje Pérendia.
Sé Pérendia kur mpshon
Ghynaqaret i - mundon.
Puna nuke ka te share
Po punoni véte nd' are,
Zini chapen é hosténe
Dhé parmenden qe chan dhéne.
Nga femia mos u - ndani
Po punoni qe te hani ;
Grurete qe beni véte,
U harrin per kete jéte.
Mé zakonéte qe kini
Kurbéne duét t' a lini.
Te ndérchim ini te zote,

Po ndéri sot s'ka te shkuar,
E - dréqta, ne kete bote,
Eshte faré shtremberuar . . . . .
Ne kurbét véne te tjére ;
Ata qe s'duane ndére.
Sot zakonét u - nderruan :
Burri qe fiton shét gruan.
Burrate rrojne nga gra! . . .
Po per Mitro Shqipetare
Keto zakoné, te ra
Nuk'i - dukéshine mbare.
Ndaj hoqi é voi shume
Kur pa buk'é kur pa ghume.
Rrau Misire te tere,
Nuke la pune pa bere,
Ghithe jéten nene urdher,
Qéséa si koke udhër !
E - shoqia é kish qare ;
Gne zét vjét qe s'é - kish pare!
Dhé ne mos é - pafte kurre,

Djali ju rrit, u - be burre:
Memen dot' a mbaje mire
Mé te ngren' é mé te pire.
Pas gnë zét vjét, nga kurtsimi
Mitros ju chtua fitimi;
Solhi ner ment Shqiperine,
Gruan' é - ti dhé shtepine;
Pshéretiti zemr' é - ti
Dhé qau si chilimi;
Dhé nésermét, ndaj te gdhire
Mitrua é - la Misire.
Ta kish ditur, kur ish ndare
Qe la gruane mé bare,
Mbasé kish ikur me pare.
Shtate dit é shtate nét:
Beri Mitrua ne dét;
Mbaroi udhen' é - ghate
Dhé vaté ne fshat mé nate.
Ne shtepi u - aferua,
Ndegni pak é u mentua

BKSH

Dhé mé vété te tij thosh :
Ne ghécha shtepine bosh ?
Ne mos é - ghécha te ghalhe
Gruane ! — Mé keto fjale
Shukon shtepine mé drite
Edhé vaté ne fénghite
Te shoje kush eshte brenda,
T' i perghoje ja ka enda.
Djali kuvendon mé meme :
— Psé qan i - thosh kur ké mua ?
Ch' kane shkuare t' i - leme,
Dhé duajme si te dua. —
— Te dua, thosh mem' é - mjére,
Mé shprése tendé kam rruar,
Nga ti harrova qédére
Dhé ghith' ato qe kam vuar,
Dhé sot rroj mé shprése tendé. —
Kur ghéghi keto kuvendé
Mitrua ngriu ne fénghite ;
Fat - ziu, ch' vuri ner mendé !

PKSH

Vuri syn ' é pa ne drite,
Pa gne trim te ri mé grua !
Mendia ju trumbulua !
Mitrua kujton Misire,
Shé vétehéne mé brire ! . . . .
O Mitro méntoju mire,
Mema perkedhél te bire ;
Nuke te ka turperuar
Sé mé ndér te math ka rruar !
Ch ' méntonéj moré fat - zi !
Rure mbrenda ne shtepi
Dhé mérr djalene ne ghi .

O bobo ! syte ch ' me pane !
Tha Mitrua si i - marre,
Pashe gruan mé jarane !
Po tani dot ' u bej varre !
Dot ' u - bié mé koburé
T ' i leshoj ne shésh shonduré
Mua te me vene brire ! . . .

BKSH

Tha, dhé goditi te birre !
Mem ' é - zéze uleriti,
Pushtoi djalen dhé briti !
Po Mitrua nuke priti :
Puchka krisi dhé gne hére,
Ra permbys dhé mem ' é - mjére !

Gomari jatro.

Qé gne hére ne gne ko
Gne gomar u be jatro ;
Vjérr ' i - ti s' punoi mbare
Kur beri dhender gomare,
Vetiut ' i beri varre
I - mjéri cho ché pandéu
Sé gomari é gegnéu.
Nga inati, nga qédéri,
Usemur gne dite vjérri.
Si é - dinté te shtreguar,

PKSH

Te sheroj u pa poguar,
Vaté gomari é thote
Dhé benté sikur fshij lote.
Tani te te sho ch' ké msuar,
Tha vjérri duk' é renkuar.
Mori ilatsn' é é - piu
Po ai qenkéj bar miu
Zorret é mulchit' i griu!
Me hélmové, tha i - ziu,
Dhé mé tetila ilaché
Nésermét u gdhi kopaché!..

Jét' é -lige.

Te mos kesh' é te mos dish,
Te jésh si gne chope mish...
Te mos dish si te punosh
Po nga gruaja te rrosh,
Ti benésh rob dit' é nate
Per tsa pak buke te thate;

BKSH

Ta durosh kur te te rraje !
Dhé te qéch kur te te shaje !
Te mos te te mbaje ndére,
Po te te thote nga hére :
« Ush ! gomar ne per shtepi,
« Si te thém u te besh ti,
« Ndryshé te le pa taghi » ! . . .
Nuke bésoj qe te kéte
Me te feliqure jéte,
Dhé gne burre q' eshte burre
S' bésoj ta duroje kurre .

Ujku békshi .

S' ka gnéri te pa mardha :
Katre motra, gne vela
Dote qéne si ata,
Sé Pérendia u - dha .
Po i - gegnén gne dzadza

BKSH

Soises é maskara ,
Ghene qe kan ' u a ha
Dhé i - mban per sadaka !
Punuan si chilimi :
Vune ujkune békshi
Te ruaje dhen é dhi !
Psé s' doli gne nga te pése
Ta dbonté qen ' é pa - bése .
S' é shone qe s ' ka te fryte ,
Djalhi u - ka zene syte !

Gne dzadza mé dy dhendurre.

O gnéri i - ndyte
Djalhi te zu syte !
(Te artht ' é te mbyte)
Nuke ké te fryte ,
U beré fanua :
Mé mbésat ' é - tua

BKSH

Rron si burr' é grua ! . . .
Ghen' u a zotové
Dhé i - turperové !
Dhé dy qe martové
U - dhé gnérs te - mbétur
Dy dochré te - ghétur !
Dy burra te - shitur . . .
Duk' é lipur rritur !
Qe te dy gomare,
Per te zene nd' are ;
Qe te dy chiplak,
S' kane pike ghak.
Te ketilh' i - ghété
Ti késh nene vété'
Ti kosh mé bobote
Sé s' jane te - zote.

PKSH

Néron i ri.

U tréte o mik u tréte,
U beré si druri thate,
Sé mban mbésate mé vété
Dhé fle mé to dit' é nate!
As ne Turq' as ne Kaure
E - tilhe pune s'ka ghare,
Katre motra mé gne burre
Dote benéne mé barre! . .
I - ké mbésa mor i - mjére!
Mire ghen' u a - zotové,
Po tu késhé lene ndére . . .
S' ké turp sé Néron é shkové!
Po ne léfte nogne djale,
Dhé per turp ne kete jéte
N' é - lente Zoti te - ghalhe!
Mem' é - zéze chdo ta kéte?
Pjélh' a kusheri te - pare? . .
Pérendi te jémi fale,
Ti qe mundon ghynaqare

BKSH

Hap dhén'é futé te-ghale;
Balta balten te mbuloje,
Te mos lere fis é fare,
Sé dote na turperoje
Tere Korchen mé Korchare!

Mik mé dy fytyre.

Psé s'te kupetova
Qe jéshé i-lik,
Fjalet t'i-bésova
Sé te dije mik.

Ne shtepi me vijé,
S'késhé pike ghak,
Ték'u haj'é pijé
Sé jéshé chiplak.

BKSH

Ta késh per levdate
Qe qéshé mé mua,
Po kthéme parate
Qe qé marre hua.



Korbi dhé Dhélpra.

(Shqiperuar).

Zoti korb gne dite, mé djathe ne goje
Ne gne dége lisi vaté te qendroje.
Nene lis gne dhélper korbin é - kish pare,
I - ra ére djathi dhé kerkon tja marre.
— Fat - mirosh me qenké! thote zogna dhélper,
Bukurine tendé nuk' é - ka zok tjéter!
Pende te florita si ndérkur i - dojé!
Te késhé dhé zene dote mbréterojé! —
Te rreféje zene, zoti korb gerhiti,
Djathet ra nga qéfti, dhélpera é - priti . . . ,

Si dhélpra, Turqia qésh mé Shqiprine:
Kur na ka névoje na mburr trimerine;
O burra! na thote, trima Shqipetare!
Ne lufte te vini te vriti me pare!

Dhélpra dhé gne koke Gréku.

Dhélpr' é-malekuar
Dolhi per te ghuar,
Ték zebrit nga brégu
Pa gne koke Gréku.
— Jashte, per te dukur,
Qenka kok' é-bukur,
Po s' paska tru miku!
Tha dhélpra, dhé iku. —

PKSH

Gruaja mé barre.

Gne grua mé barre
Ne shésh po renkonté,
Therrit duk' é - qare
Sé s' munt te shpetonté.
E - mjéra sé ch' hoqi !
S' ghentéj dot réhat !
Ngréu, thosh i - shoqe,
Te shtriésh ne shtrat ;
Te lutém ndeghome,
Shko te pjélch ne strome.
— Ch' kuvendon or burre?
Dote ndeghoj ty !
Barku ch' fryét kurre
Atjé ték u - fry?

BKSH

Lopa, dhia, délia dhé aslani.

(Shqiperuar)

Mos beje kurre gnéri
Mé te medhéj shoqeri.

Lopa, délia dhé dhia
U - bene shoq mé aslane,
U - ndane nga baketia
Dhé per gha gne dite vane.
Kur rune nde gne perrua
Aslani thote : qendroni !
Dhé ndegni pak u - menua ;
— O shoke, thirri, ndegoni :
Ch'me duéte ghau mua ?
Lopa, délia dhé dhia
Jane mjaft, te tjéra s'dua ! —
Dhé i - chau qe te tria.

BKSH

Qeni dhé hiéja.

(Shqiperuar)

Gne qen mé cha mish ne goje
Ne per lume dote shkoje.
Ujet eshte si pasqyra:
Qenite ju duk fytyra,
Ju duk dhé mishte me shume!
Ryti t'a zere ne lume.
Fat-ziu mbéti pa mish
Sé humbi dh' ate qe kish
Sé é la é-mori vala.
Neghoni ch'thote perrala:
Gnériu qe ve tama
Humbét dhé ghene qe ka.

Ujku dhé Qenghi.

(Shqiperuar)

Gne qengh pinté uje, brenda ne perrua,
Gne ujk é-kish pare dhé ju aferua.
Psé trumbulon ujet? thirri ghaketori,
Sé kur é pa, qenghi nga frika permori.
— Ujet vété poshte, ti pi per mi mua,
Thote qengh'-mjére, qysh u-trumbelua? —

BKSH

— Jane ghaste muaj, psé me késhé share ? —
— Une s ' késhe lére, ku te késhe pare ? —
— Per zone, tha ujku, ati yt me shau ! —
Dhé u - hoth é - zuri dhé mé dhemb ' é - chau

Mé ghak, mé te rremé, mbréteron dhé Turku,
Pa faj na ha koken, sé punon si ujku ! .

Eva dhé Shejtani .

Ghith ' é dine ch ' kémi qene
Dhé pastaj qysh kémi rene :
Qe te prishét gnérezia
Te ndaét nga Pérendia ,
Shéjtani dolhi nga dhéu
Dhé Even vaté gegnéu ,
Edhé Eva me pastaj ,
Gegnéu burren é - saj . . .
Dhé é kandisi , fat - zine ,
Te harroje Pérendine .
Q ' ate dit ' a q ' ate nate
Burrat bejne ch ' thone grate . . .
Edhé grate , (qofte lark) ,
Kane shéjtane ne bark .

Shtate hére fajtor ?

Nga mendja juaj mos dili
Po ndeghoni ch' thot' Unghilhi :
Ne gne dite, burr ' i - mjére
Ryn nde ghyna shtate hére !
Po m ' é - ndérchimja nga grate
Sa ghyna ben ne gne nate ?
Unghilhi s ' désh t ' i - trégoje
Sé s ' mundi t ' i - numuroje .

Gnériu i - shtrenguar

Kush esht ' i - strenguar
Dridhét per parane :
Ghithe ch ' ka fituar
S ' i - ha po é - hane !

Nuke ménton, lumi,
Sé ka per te vdékur,
Dhé kur é - ze ghumi
Bié fle si ljépur . .

Ruan ghen ' é - tia
Tja hane te tjére,

BKSH

Dhé vdés nga uria
Mos me kéq i - mjére !

Gréku dhé Shqipetari.

Gréku : — Psé, ju Shqipetare,
Kini djém te mbare,
Te zghuar, te zote,
Te fort é te plote ?
Shuko djémte tane :
Sikur nuke hane,
Te vérdhe, te thate,
Te trembur si grate,
Te liq, te pa - bése,
Pa turp é pa shprése . . .
Ghak ne zemer s' kane !
Tuajte psé jane
Trima te vertéte ?

Shqipetari : — Sé i - bejme véte .
S' na ndine te tjére,
Si ju, mor te - mjére .

E - Shtune ! é - Diéle !

(Shqiperuar)

Mbane pusite, gne hére,

PASH

Ndegni gne Chifut i - mjére ;
Nuk ' é di si u - ndoth bosh ,
U - keput é ra perposh !
Gne Kaur andéje shkonté ,
E - ndeghoi ték renkonté ,
Dhé vaté pruri gne shkalhe ;
Po Chifuti s ' désh te dale :
« Sot eshte , tha , é - Shetune
Dit ' é kremté per Chifune » .
— Si te duash , i - tha miku ,
Dhé mori shkalhen é iku .
Chifuti , si ja désh enda ,
Mbéti ate nate brenda ,
Ndegni pa ngren ' é pa pire .
Dhé nésermét , ndaj te gdhire ,
Chifuti kerkoi shkalhe
Qe te mundije te dale
Dhé te shoje drit é diélh .
« Po sot eshte dit ' é Diél ,
« E - kremté per te Krishtere ,
« Sot s ' punojeme te tere » ,
Tha duk ' é qéshur Kauri ,
Dhé iku é shkalhe s ' pruri .

Burri mé grua.

(Shqiperuar).

Markua dote vdése,
Nuk ' i - mbéti shprése,
Dhé gruas i - thote
Duk ' é fshire lote :
— Dote vdés moj grua :
Jam kéq i - semure !
Po hajdé me thua :
Qe kur me ké burre,
Ma ké mbajtur ndére ?
Nga mua, me mire
Ké dashur te tjére ?
Me ké vene brire ?
Fole, mos ki frike,
Trégo te vertéten,
Sé dhé per gne chike
Dot ' a humbas jéten.
— Po n ' u - sherofsh prape ?
E - shoqja i - thote
Dhé mori gne nape
Per te fshire lote.

BKSH

DRERI.

Kenge. (Shqiperuar)

1.

Kush vjén te vémi per gha
Sé tani koa u hap?
Dhé chifté kush nuke ka
Te vije ték'u t'i-ap·
— Ik'o mik, étse per gha,
Lé jot shoqé me shtepi,
Sé ka hédhure sévda
Dhé prét te largonésh ti. . .

2.

Ti vété te godich dérre,
A gne ljépur, a gne dre;
Gne ajdut te run me dére,
Mé jot shoqé bié fle! . . . .
— Ik'o mik étse per gha,
Lé jot shoqé me shtepi,
Sé ka hédhure sévda
Dhé prét te largonésh ti. . .

3.

Dreri perpiqét me gn'ane,
Lavosét bié ne shésh;
Dhé jot shoqé mé jarane
Ne shtepi po lot é qésh! . . .

BKSH

— Ik'o mik étse per gha,
Lé jot shoqé me shtepi,
Sé ka hédhure sévda
Dhé prét te largonésh ti . . .

4.

Ti rjép drene qe ké vrare
Dhé langoi ghakn' i-pi;
Jot shoqé benét mé barre
Mé mikne qe ka ne ghi.
— Ik'o mik, étse per gha
Lé jot shoqé me shtepi,
Se ka hédhure sévda
Dhé prét te largonésh ti . . .

5.

Ti mérr dren'é-ve ne hélh,
Vjén ne shtepi mé deshire;
Ahéré jarani dél
Edhé run dreri mé brire! . . .
— Ik'o mik étse per gha
Lé jot shoqé me shtepi
Sé ka hédhure sévda
Dhé prét te largonésh ti . . .

BKSH

O bobo! (kenge)

O bobo ! é u bubu !
Mikia ner ment é vu :
Ne shtepi te saj me shpu,
Sé nenén s' é kish ketu ;
Po shéjtani na i - pru
Dhé na ghéti ghu - pre - ghu! ! . .
— Bije ch' eshte ky ketu ?
— Moj nené mos shirre kshtu ;
I varfer é i vjén uu,
Dhé kerkon kulach te gru . —
Thote plaka i ap u
Dhé vaté mori gne dru ! . .
Ik' ajo é ike u . . . .
M' uzu kemba me gne hu,
Vrava te shkrétine ghu
Edhé rashe si kertsu !
Plaka po vinté tehu,
Erdhi nga véshi me zu
Dhé me dha kulats te gtu ! . .

PROOF

VARFERIA.

Kenge. (*Shqiperuar*)

Me thone tsa gnérs te marre:
Psé nuke kurtséj parane?
Psé nuke silhém i-mbare?
Psé nuke ve ghe me gnane?
— Ata qe thone keto.
Jane mé tru te semure,
Sé ai qe s'ka sa do,
Nuk'i téperon ghe kurre.

Me thone te punoj shume
Edhé te fle pa tama;
Po diten é-shkoj ne ghume
Sé nuke kam sé ch'te ha!
— Ata qe thone keto,
Jane mé tru te semure,
Sé ai qe s'ka sa do,
Nuk'i téperon ghe kurre,

Me thone, duk'é qertuar,
Andon, hiq dore nga grate!
Po as gne s'm' esht' aferuar
Se shone dzépne te thate...

BKSH

— Ata qe thone keto,
Jane mé tru te semure,
Sé ai qe s'ka sa do,
Nuk'i téperon ghe kurre.

Me thone qe s' silhém mire,
Nuke mblidhém ne shtepi.
Ne bié fle ndaj te gdhire
Jam béqar s' me prét gnéri...
— Ata qe thone keto,
Jane mé tru te semure,
Sé ai qe s'ka sa do'
Nuk'i téperon ghe kurre.

Me thone te mos pi vére,
Mé raki te mos gegnémém.
Po si te harroj qédére
Kur te mos pi sa te déjém?
— Ata qe thone keto,
Jane mé tru te semure,
Sé ai qe s'ka sa do,
Nuk'i téperon ghe kurre.

BKSH

KATREMBEDHJÉTE VJÉCH DHENDERR!

Komodi é - vjérsheruare

MÉ KATRE PAMJÉ.

BKSH

GNERST'É KOMODISE:

Zoti Vanghél:	plak i-pasur.
Zoga Tane:	grua é-ti.
Ghini:	djal' i-tyré.
Marigo:	nusé é-ti.
Zogna Kotè:	kusherir'é Tanes
Zogna Briri:	gne léhone.
Gne milhona.	

Prifti.
Nuni.
Brodani.
Abazi
} Krushq

Gra, burra te tjére, chupa, djém.

BKSH

Katrembedhjéte vjéch dhenderr !

Pamj é - pare : Burr' é grua.

(Eshte nate. Mbrenda nde gne ode par te flétur zoti Vanghél é zogna Tane behén azer per te renur poshte. Ne funt te odes ndrit gne lampe afer shtratit,)

Tana. Negho, burre. . . .

Vanghéli. Ch' ké moj grua ?

Tana (rencon). Jam semure.

Vanghéli. Qe kur ! ch' thua !

Tana. Ch' thém ? ja thém qe jam semure :
Koka me dighét si furre ;
S' é' - késhe pesuar kurre. . , .

Vanghéli. Po tani valhe ch' pesové ?
Me dukéte sé u - ftové :
Ghithe naten u - zbulové ;
S' di sé sa hére me zghové ;
Dhé s' me lé faré te flere ! . . .

Tana. Ghithe diten ch' késhé bere ?
Ti per bar é per dru s' vété,
Dhé qaéj sé nuke flété ?
Tere ditene ngas qéte,
Dhé drék' é darke bej véte !

BKSH

Ghithe puna permi mua !

Vanghéli . Persé te kam marre grua ?
Grate per pune po jane .

Tana, qésendis . Edhé burrate te hane,
Dhé te rrine nat' é dit ! . . .

Vanghéli, mé inat Mos me ben te te godit ;
Sé zakone s' é - harrova . . .
Sonté shume te durrova . . .
Nga hunda s' me héq dot kurre . .
Sé nuke jam si ch' do burre !
Jam Shqipetar i - vertéte,
Dote bej si dua véte !
Ch' ké qe s' pushon duk' qare ?
Nga u ch' te lige ké pare ?
S' te kam lene, si te tjére,
Vétem, te shkrét' é te mjére . . .
Nuk' ika kurre nga fshati.
Ea, s' te skoi inati ?
Ngréu te biém te fleme,
Dhé keto fjale t' i - leme .

Tana, Bjér' é fli, mua s' me fliét.

Vanghéli . Néser, porsa qe te gdhiét
Dot' dergoj djalen mé vrape

Te bjére jatrone prape.

Tana. Tsine jatro?

Vanghéli. Adhamutne.

Tana. S'é sho dot mé sy Chifutne,
As per matsé s'i-ve bése...

Vanghéli. Lé moj grua t'a therrése.
Koken munt te t'a sheroje.

Tana. Nuk'é-dua te me shoje!
Te bukur jatro qe ghéte...
Me prahir te ruaj qéte.

Vanghéli. Mos kuvendo kshtu moj grua.

Tana. mé inat Nuk'é-dua, nuk'é-dua!
Psé s'sheron gruan é-ti?
Sé nga ajo ha é pi..
Ndaj é-mori mé gne sy
I-dalchine qe te dy.

Vanghéli. Ch'jatro ti te bié une?
Mitrua s'eshte ketune;
Dhé Naum koke shiniku
Ketéje natene iku...
Ne vendé te tjére vane,
Ketu véteme na lane!
Ikn'é muarre Misire,

U hanté koka per brire! . . .

Tana. Prapa diélhit te véne
Sé ch' ndéruan memedhéne.
S' jam semure per jatrua
Sé s' me ka ghe koka mua;
Po te me ndeghosh gne tjale. . .

Vanghéli. Fole, ch' dote thuash valhe!
Dot' me lesh dhé sot pa ghume?

Tana. Kémi ara, vréshta shume. . . .

Vanghéli. Te ghitha ch'duén i kémi,
Si do véte Zoti jémi;
Si né s' ka shume te tjére. . .

Tana. Sa qé é - ndyéra vjérre,
Pas takatit pléqerise.
Bentéj punet é shtepise,
Dhé kur kthénéshe nga ara
Gheje darkene perpara;
Po tani ch' te bej me pare,
Ne veshte te jém a nd' are?
Te te bej dhé drék' é darke,
Tani s' munt sé jam me plake.

Vanghéh, Plake? s' jé plake moj grua,
Po jé ashtu si te dua . . .

Tana, mè te lutur. Te te vije kéq per mua :
Punete jane te renda ;
S' punoj dot jashte dhé brenda . . .
Vanghéli . Puno sa te duash véte :
Arat' épi mé te tréte .
Tana . Kjo pune s' benéte kurre ,
Po djali na u - be burre . . .
Ndaj te lutém t' a martojme ,
Erdhi dita te gezojme ;
Né , pa nusé psé te rrime ?
Kur te kém nuséne ndime
Punete benéne véte .
Nuke rojeme mé jéte ! . . .
Psé s' me flét ?
Vanghéli Ch' te thém moj grua ?
Chuditém mé ch' fjale thua !
Katre mbedhjéte vjéch djale
Do t' a martosh ?
Tana Sa jam ghalhe
Dua te gezoj si meme ! . . .
Vanghéli Ea te biém te fleme . . .
Tana Ti ch' me thua , u ch' te thém !
Sikur kémi shume djém !

BKSH

Mé Ghine mbéti kjo dére.
Vanghéli, Qasu te te béj te tjére,
Te pjélch pa mbushure moti . . . .
Tana, duk é qare. Mé fjale je shum' i - zoti
Vanghéli. Ch' ké qe qa prape tanine ?
Tana, mé lot. Ku te mos qaj un' é - mjéra ?
U te flas mé pérendine,
Ti me flét fjale te tjéra !
Vanghéli. Ea moj grua ner mendé.
Tana. Chuditém mé koke tendé.
Vanghéli. Sado qavé, ngréu bjére . . .
Tana. S' jé baba si dhé te tjére ! . .
Thuajme, per Pérendine,
Psé s' do t' a martojme Ghine ?
Vanghéli. Esht' i - vogele moj Tane !
Tana. Ch' thua ? pa shukoi shtane :
Bota nuke shone vjéte ;
Shié sa mori perpjéte :
Dukéte gne zét vjéch djale
Kur hipen é bréth mé kale.
Mé mua kur u - martové,
Sa vjéch jéshé, mos harrové ?
Tani, per djalene tone,

Do te nderrojme zakone ?

Vanghéli . Mos kerko ch' benim gne hére,
Po shuko ch' bejne te tjére:
Shuko béjne, rregne dale,
Nuke ka dhé ai djale ?
Kur i - thashe t' a martoje,
« Lé te beje si te doje,
« S' me ha malhi per t' im bire,
« U per vété te rroj mire, »
Me tha dhé me kthéu krate .

Tana . I - muarre mente grate ! . . .
Te bukur gnéri qe ghété !
Ai te kish ment per vété !
Nuke shkrétonté shtepine,
S' kish marre porropotine !
Mendjé prishur, zemer - ligu,
La te shoqéne dhé iku ! . . .
E - zéza grua sé ch' hoqi,
Gne zét vjét é - la i - shoqi !
Dhé ne pléqeri q' é - poqi,
(Te mos arrij te kish ardhe)
Nuke pa dite te bardhe ;
Nat' é dite duk' é qare

Nga turpéte qe kish pare . . .
E-mba ment ch' grua ka qene ?
S'kishté shoqé ne vent tene :
E-ndérchimé, zemer-mire,
Punoj' é rriti te birre ;
Ka qene grua per mbréne ;
Burri s'ja diti qiméne : . .
Dhé tani ne pléqeri
Dashuri me dashuri !
E ghéte nga Pérendia
Sé prishi shtepine é-tia.
Gruaja vdiq nga qédéri !
Kete kerkonté dhé dérri ;
Tani mban disa te tjéra,
I-vafte shpyrti ne térra ! . . .

Vanghéli. Psé kuvendon kshtu moj Tane ?
Gnérst' é-medhéj kshtu é-kane :
Gnérst' é-tyré i-mundojne,
Duan' ata q' i-levdojne . . . .

Tana. Ne bejne kshtu te medhéjte
Djalhi t' - marre per jéte ! . .
Béu djalen t'a martoje !
Mé sy nuke do t' a shoje !

Sé ne turpé do te rroje
Si ka rrojture nga hére ! . .
Dhé gudzon é mson te tjére !
Ka lojture nga fiqiri .
Gne dite me thosh i - biri :
« Baban é mire ndéroé .
« Dhé baban ' é - lik duroé . »
Dote benét djal ' i - mbare
Sé me memene ka ghare ;
Pa ne ghafte me babane . . . . . .

Vanghéli . Migni gdhiéte moj Tane !
Tani lé béjne me gnane
Dhé hajdé té fleme prane ,
Ea sé me mori ghumi . (shtriét) .

Tana . Dhé mua me mart lumi !

Vanghéli . Pa dhé néser kuvendojme .

Tana Djalene dot ' a martojme ?

Vanghéli . Pa te shome . . .

Tana. Cho te shoch ?
Nuke do te me ndeghoch !
Ndegho dhé mua gne hére .

Vanghéli . Te ndeghoj po hajdé bjére .

Tana Te vi po te me apch tjalen

Qe dot' a martojme djalen .

Vanghéli . Puna s' benét mé gne nate ,
Do méntuar ghér é ghate.

Tana . Ch' do mentuar, pa me thua ?

Vanghéli . Ch' vajze dot' i-apem grua ?

Tana . Mos é-ki kete qédér :
Djalen tene kush s' é-mérr ?
Kush nuk' é-do Ghinon tim
Q'eshte nga trimat me trim ?

Vanghéli . Trimerine s'ja nze dhéu !

Tana . Nuk' eshte si djele béu . . .
Po esht'-imir' é i-mbare,
Kush t'a-rembéje me pare ;
S' eshte no gne djal' i-mbétur ;
Une musén ja kam ghétur.

Vanghéli . Ja ké ghétur ! Po ch' é-thone ?

Tana . Chupen' é ghitonit tone.

Vanghéli . Tsine chupe, Marigone ?
Chupen é zotite Koré ?

Tana . E-bukur' é punetoré.
Mos pyét sé ch' grua eshte . . .
Si per ara dhé per veshte,
Pun' é-saj s' ghendét ne jéte,

Punon véteme sa dhjéte!
Nuke thém mire? ti ch' thua?

Vanghéli. Ne do te me ndegosh mua
Ghini, Katone te mare
Te beném krushk mé Korchare
Ara, vréshta, shume kane.

Tana. Po kane véqil dzadzane
Nuk' u-ép buke te hane!
Jane per te qare hale
Sé te tjér u-hane malhe:
Ték ata qe s'kane ment
Erghindi nuke ze vent.
Dzadzai psé s' i-marton?
Sé véte, thon' i-punon! . . . .

Vanghéli. Thone bota per dzadzane?
Kjo pune s'benét, moj Tane,
As ne Turq as ne Kaure.

Tana. Tym pa zjarr nuke ka kurre.
Ndaj s' i-do gnéri ne fshat,
I-shukojne si lugat. . .
Kane dhé Jorghin kunat
I-nzjérr véte ne « mézat »,
I-taks andéj' é ketéje,

Tsine munt qe te gegnéje:
Gegnéu gna ghasht' a shtate!
Te mjéret! humpne parate
Sé harruane dzadzane
Q' é-kish vluar mé chobane.

Vanghéli. Mos ndegho bota sé ch' thone.

Tana. Ti psé s' é-do Marigone?
Ajo nusé ben per mua.

Vanghéli. Po esht' é-madhé, moj grua.
Gne zét vjéché!...

Tana. Kaq' é-dua:
Nuke marr nusé per sise,
Po per punet' é shtepise,
Te dije te ngase qéte
Sé nuke munt t' i ngas véte,
Te na bjére dry nga mali....

Vanghéli. Mire ti, po ch' thote djali,
Ghini mé te do te rroje?

Tana. Do-é-mos qe dote doje!
Psé kuvendon kshtu mor burre?
Pyétén femia kurre?
T'a martojm' ashtu me rruash.

Vanghéli. Moj grua, ben si te duash,

BKSH

Dhé me qafe t' i-késh véte . . . .
Tana. Em ketu ém n' ate jéte .
Néser dot ' vété te bluaj ,
Te shetune te gatuaj ,
Te Diél te bejme darsme ,
Ghithe miqte t ' i-gershasme. (qa)
Vanghéli. Tani psé qa ?
Tana. Qa nga gazi ;
Me shpetové nga marazi.
Tani dote beném vjérre !
Vanghéli. Shuaj driten, dhé shko bjére .

(Te dy bién te flene ne shtrat. Pérdéa mbylét)

PAMJÉ É-DYTE

Ne Mulhi .

(Brenda ne gne mulhi dy gra présen te bluajne : Zogna Tane dhé zogna Koté. Gur ' i mulhurit po Kthénét. Dykéne thasete mé drithe prane koshit. Zogna Koté kerkon te bluaje me pare po Tana s' é-le)

Tana. Ch' ben ashtu moj Koté ?
Koté. S' eshte puna joté.

BKSH

Tana. Moj mos jé é-marre?
Kam ardhe me pare.
Koté. S' munt te rri ketune,
Kam te tjéra pune,
Po hiqu nga une. . . .
Tana. Ch' thote kjo *murtaje!*
Kotè. Ujku te te haje.
Tana. Tutjé, mon *mandate!*
Kam ardhe mé nate.
Kotè. Thuaj si te duash
Sé u dote bluaj.
Tana. Nuke dote bluash,
Sé u ketu ch' ruaj?
Koté. Ruaj milhomane
Sé kur te ka prane. . . . .
Taua. Ftu! moj goje ndyre,
Moj turi letyre!
Ch' é-kam milhonane?
Kam burrene prane. . .
Ti ku é-ké ndére,
Qe perflét te tjére?
Po ghithe te dine:
Harrové békshine. . .

BKSH

Sa hére te zune ?
Koté. Mé békshine, une !
S' turperonéj pake
Sé jé grua plake !
Tana. Plake ? pa hap syte,
Kush eshte m' é-ndyte ?
Jéshé ti per burre ?
Ndaj iku i-mjére
Dhé s'te vjén me kurre
Sé i-prishé ndére ! . . . .
Koté. Moj kurve, moj shtrige !
Tana. Moj grua é-lige !
Koté. Moj stérre, moj nate !
Tana. Moj goje lopate !
Koté. Moj byth' é kusise !
Tana. Tmér i gnérezise !
Koté. Na ! porr' ato pach
Kur kerkon te shach !
Tana. Tutjé moj zagaré !
Koté. Tutjé moj murdaré !
Tana. Ike moj bisht drédhur !
Koté. O moj brasgn' é-hédhur !
Tana. O moj vjédharaké !

RKSH

Koté. O Moj shulanaké.
Milhonai. Ch' kini qe therrine,
Pak turp nuke kine ?
Ini kusherira !
Silhi si te pira !
Psé therrét moj Koté ?
Koté. S' eshte puna joté.
Milhonai. Zogna Tane ch' pate ?
Tana. S' kam ardhe mé nate ?
Koté. Po sé psé ké ardhe ?
Tana. Te bluash mé radhe !
Milhonai. Thote mire.
Koté, shtyn milhonane. Ch' thua ?
Milhonai, Psé shtyn, ch' ké mé mua ?
Tana, te milonaj. Ch' é-shukon, ch' i-thuaj ?
Kam ardhe te bluaj,
Sé martoj évlane !
Milhonai. Ch' faj te kam moj Tane ?
Tana. Lé thésne, moj nate !
Milhonai. Kthénét guri thate !
E-ghéch me Pérndine !
Me prishte mulhine ! . . . (ben te dale)
Tana. Ku véte ;

BKSH

Milhonai. Ch' me thuaj ?
Tana. Kur te vi te bluaj ?
Koté. Kurre, kurre, kurre ! (dhé iken)
Milhonai. Kur te skalis gurre.
Milhonai. Ike ne ké pune
Pat' a bluaj une.

Tana. Sa te ndréqéte mulhiri,
Dot' vété té zogna Briri
Ka dy dit qe polhi, msova
Dhé akoma s' é-urova ;
Te vété sot t' a-uroj
Edhé me darsme t' a ftoj.
Shuko mos me lesh pa miélh !
Te vich me darsme te Diél.

PAMJÉ É-TRÉTE.

Urimé.

(Nde gne ode per te flétur, zogna Briri gatuan ghélh per te ngreue, kur run zogna Tana per te uruar. Kur é shé, zogna Briri qe eshte léhone dhé

ka frike sé mos marre sysh, shtriét ne strome prane foshgnes qe ka pjélhe é q'é-ka vene ne djép.)

Tana. Mire qe shepetové!
Po ch' dit' u-lerové?

Zogna Briri. Duk' é gdhir' é Marre.

Tana. Qofte kembe mbare...
Dy dit qe ké pjélhe
Dhé ngriéj ben ghélhe!
Kshtu jéshe dhé une:
Polha te Shetune,
Te Diél u-ngrita
Dola é vadita;
Dhé djalen é'-pare
E-kam bere nd' are!
Ne piqi é-vura,
Ne shtepi é-shpura,
Dhé ne sis' é-kisha,
Kur érdhe nga kisha,
Burri u manit
Vjérra u chudit.
U-ngréch underrova,
Zura é gateva,
Drék' é' darke shtrova.
Sot te tjéra thone;

BKSH

Kush eshte léhone
Jashte te mos dale;
Keto jane fjale! . . .
Hengré nögne chike?
Pivé no gne pike?
U-mundové shume?
Psé s' flét, mos ké ghume?
Dote rri dhé pake
Sé s' kam bere darke;
S' iki pa shukuar
Foshgnen' é békuar. . .
Ftu, ftu, ftu! te rrofte,
Zoti t' a dhurofte,
Kembe mbare qofte!
Po si lul' é Mait! ! .
Nuk' i-ghan babait;
Ghyshit i-ka ghare;
Ti s' é-késhé pare:
Qé gne burr' i-bukur,
Nga shoket m' i-dukur. .
Ndjése paste! Mua
Doj te me mir grua;
Mema mé babane
Gne tjéter i-dhane.

BKSH

(**të foshgna**) Ftu' ftu, ftu! mos qa.
(**të mema**) Pa shi valhe ch' ka ?
Pa nziré nga djépi,
Ne do sise jépi.
(**të foshgna**) Ch' ké qe qa moj zemer ?
(**të mema**) Mashkulh esht' a femer ?
Zogna Briri Vajze.
Tana. Te te rroje,
Zoti t' a madhoje.
Ndaj te sho mentuar
Dhé the hidhenuar!
Zogna Briri. Doje te qé djale.
Tana. Ch' jane keto fjale ?
Ch' é kéqé te zuri ?
Te te rroje burri: —
Mé shéndét te vije,
Ju ini femije. . . .
Psé qésh ? ték te thém:
Dote besh dhé djém.
pshyn foshgnen) Ftu, ftu! Kush t' a shoje
T' a mpshuje ne goje
Eshte lodertaré,
Si motemocharé !

Shume gnérs moj bije
Kane per femije
Sy te lik, mos qofte!
Zoti é-verbofte!
Une, pacha zone,
Mos ndegho sé ch' thone,
Sé kam sy te mbare:
Gne dite te mare
Poqa Sanen nd' are;
Punonté sa katre!
Si thashe ghe tjater.
Puna mbar' i-thashe
Dhé ika é-lashe;
Sana qé mé bare
Po s' é-késhe pare!
Ter' diten punoi,
Natene deshtoi!
Mua m' a ngarkoi!
Dil é thosh, murtaja,
Té shoqét é-saja
Dhé ne ghithe bote
Duk' é fshire lote:
Tana, zemer-liga,

BKSH

Me vu syne, shtriga,
Pandaja deshtova !
Po pas cha dit msova,
O moj zogna Brire,
Qe Sana kish shtire
Sé burri qé pire . . .
Dhé é-rrau mire !
Mbremané. ndaj naté,
Mé gne bisht lopaté,
Sé s' kish bere ghélhe !
Pa shi ch' ka jot pjélhe ?

te foshgna . Ch ' ké moj vogelanè ?
Ch ' do moj bukuranè ?
Ch ' me kerkon, ch' me thua ?
S' me di, s' me gné mua ?
Une jam hath Tana.
Korba ! ra kambana !

Zogna Briri, Mori « spérinoi » !
Tana . Moj motra, s ' me thoi ?
Briri . Shkoi dit ' é-shkréte !
Tana . S ' bej dot as dy péte.
Kush ndeghon Vanghélhe
Kur nuke ka ghélhe ?

BKSH

Sot dote durojme,
Shkojme si te shkojme,
Mé buk' é mé ghize.
Tani nemni ize;
Me mbajtit mé fjale!
Mos u-nodhét dhale?

Zogna Briri. Sot tunda.

Tana. Me rrofsh!
Te mos kthéném bosh.
Pa baketi jémi,
Dhé dy dhi qe kémi,
Sivjét mbéne shtérpa,
Si Syska dhé Béjka.

(ngriét) Nat' é-mire! ika.

(Kthénét prapé) Vaj! me rente pika...
Moj korba s' me thoi
Kush é-pagezoi?

Zogna Brirri. Zoti Koto, véte.

Tana. T'i roj' é t'a kéte!
I-lumt' ajo dore,
Vente dhé kurore...
Ch' emer i-ka vene?

Zogna Briri. E-quajti, Hene.

Tana. Moj stérra! moj nata!
U arthte mandata! . .
Zemern m' a-lenduat
Nuk' u-turperuat!
Zogna Briri. Cn' pate?
Zogna Tane. Ch' faj me kini?
Beni sikur s' dini?
Vajza q' me ka lene
Nuke quéj Hene?
(**duk' é qare**) Gne zét vjét mbuluar!
Me ka perveluar. . .
Kur ghégh kete emer
Zuritém ne zemer!
E-zéza ch' ndeghova!
Dhé arch' é urova!
Mos é-trashegofshi!
Si un' é pesofshi! . . .
Zogna Briri. Me t' u-thafte ghua!
Tana. Qenkéj palo grua!
Qenki gnérs te ndyte! (dhé dél)
Zogna Briri. Mos te pafsha syte! . . .

BIBH

PAMJÉ É-KATERTE.

Dit é darsmes.

Nde ode te krushqét sufra shtruar plot mé mish te pjékur ne hélh. Burra, gra, chupa, djém, kendojne a hidhéne valhé. Choku kercét no-gne puchke. Burrat é-shtrojene mé dolhi, dhenderri rri me kembe, dhé dy a tré trima qirasin krushqit pas urdherit "dolhi-bashit". Keto te ghitha benéne me darke.

I.

Grate vétem

A te pelqén nusia,
Moré djal'o lulia?
Esht'é-mir'é shoqé s'ka,
M'é-mire nga ghithe na.
Nusia si zoge déti,
Si kur eshte bije mbréti.

Gra é burra bashke:

Ch'mire ja bem krushkese
Qi muarm te bijene,
A te me te mirene:
Maro nghéraqinene.

(Burrat vétem. ne valhé)

Moj unaza rréth mé ar,
Per grua dote te mar ;
Ghithe te kane nakar .
— Nakar lé te kishnine
Sa te mos peltsisnine

Moj unaza rréth flori,
Ghithe te kane zili
Sé dote te marr nde ghi.
— Zili lé te kishnine
Sa te mos pletsisnine .

II .

(Burrat rrine perdhé te pine mé doli)

Nuni . Djale, bjére
Shtjére vére,
Shtjére, shtjére
Ne te tjére . .
Pini vére
Mor te mjére,
Sé qédére
Dot ' ua nzjére .

Ghithe burrat. Kush é-pi kete doli ?

BKSH

Zoti nun mé trimeri,
I-gezofshim me shtepi.

Nuni, tè prifti. O Prift, te kam ghétur,
Pa pire ké mbétur,
Te ghej mé kupe mé vére
Te embele si shilqére.

Prifti. Ték'une mir'sé te vish.

Nuni. Kete t'a dish é t'a pish
Per shendét te dhenderrit
Qe rri me kemb'é drémit.

Ghithe tok. Shendét te mire te kéte,
Te trashegonét per jéte!
(kercét gne puçke)

Prifti, tè nuni. Zoti, nun, mir'sé me érdhé,
Po véren psé na i-dérdhé?

Nuni, te prifti. Mir'sé te ghéta, urate,
Te késh jétene te ghate.
Kupen é-piva mé funt...
Dhé me tutjé mo é-tunt,

Prifti. S'é-pi dot, jam prift gnéri

Nuni. Te di, urate, te di....

Prifti. Kur é-ben emere véte,
Pike ne kupe mos mbéte!
Ti qe vuré sot kurore,

Pagezofsh édhé mé dore.

Ghithe tok. Nuni qe vuri kurore
Pagezofte dhé mé dore.

Prifti. Urdher, o nun, sé jam plak,
Te lutém, beme konak

Nuni. Konak ? ghej Vanghél' é-shkréte.

Prifti. Kete kerkoje dhé véte !
Vanghél é-mira te ghéte.

Vanghéli. Mé gne kupe cho te jéte ?

Frifti. E di mire kush martonét ?
Djali te te trashegonét :
Dot' a pi pas urdherit
Per shendét te dhenderrit !

Ghithe tok. Dhenderri te trashegonét,
Te gezonét' é te shtonét !

Vanghéli. S' é-pivé te ter' urate !

Prifti. Per mbys é-kthéva, s' é-pate ?

Vanghéli. O prift mire sé urdhrové,
Rrofsh é qofsh qe me ndérové;
Dhé dolhi-bashi na rrofte,
Dhenderri ju trashegofte.
Gezofs dhé me dére tendé.

Nuni. Dhé zoti te dhente mendé. . .

Vanghéli. Une véren s' é-kam pire

Qe te mos kuvendoj mire . . .
Po dilmi paskam ment pak,
Te lutém beme konak.

Nuni. Ch' konak kerkon te me thuash ?

Vanghéli. Dergome ku do te duash.

Nuni. Zotne Brodane te ghesh
Dhé si te duash te besh.

Vanghéli. O zoti Brodan te ghéta.

Bradani. Mir' s' érdhé, t' u nghate jeta.

Vanghéli. Kete kupeze, t' a dish,
Per dhenderrin, plot t' a pish

Ghithe tok. Dhenderri shume te rroje,
Jéte te mire te shkoje.

Brodani. Zotroté qe ghété mua,
Me shtepi t'a pacha hua ;
Dhé doli-bashi mé ndér
U befte dhé véte vjér,
Dhé rrofte sa shkemb' i malit

Nuni. Gezofsh me darsme te djalit.

Brodani. Ku dot' me dergosh te pshétém.
Sé dote pi é mos déjtem.

Nuni. Etse pshétu té Abazi,
S' ka pir' é ju tha gurmazi.

Bradani. Te ghéta, Abaz i-mjére.

Abazi. Kshtu te me gesh kurdo hére
Brodani. Kete kupe dot' a kthéj
Per shendét te kete béj *(rrefén dhenderin)*
Ghithe tok. Mé nusé te trashegonet
Nga é-liga te mergonet!
Abazi, té nuni. Doli-bash, te qotsha fale,
Zoti te falte gne djale.
Nuni. Rrofsh é qofsh.
Abazi. Kush me ka ghétur?
Nuni. S' é-ndeghové? késhé flétur?
Te ka ghétur Brodan Duni.
Abazi. Me ké ghétur, thote nuni;
Te ghét' é-mira per jéte,
Te rrosh sa te duash véte.
Ghithe. S' mba ment? u-déjé pa pire!
Abazi. Dhé ne mos kuvendoj mire,
Un' i-mjéri jam choban,
Sos jam, fat-ziu, ne stan,
Dhé sos ini dhen é dhi,
Te di per tsino te pi.
Nuni. Ky eshte shendét i-pare
Per dhenderrin, mor i-marre.
Abazi. Sa malét, o nun, te rrosh:
Tani ku dot' me dergosh?

BKSH

Sé dua te pi gne vére.

Nuni, numuron. Gne, dy, tri... s' ka me te tjére.

Abazi. Numuroi dhente mire.

Nuni. Lé te kolét kush s' ka pire....
Mé mua, zoti Abaz.

Abazi. Te ghécha kurdo mé gas.
Kete kupe dot' a pi
Per shendét te dhendrit ri.

Ghithe tok. Shendét te mire te kéte
Dhé te gezoje per jéte:
I-zot' i shtepise rrofte.
Dhé djali ju trashegofte.

III.

(Sosét dolia dhé prifti ngriét é ze valén mé burra, duk' é-kenduar):

Dote thém gne kenge véte,
Kenge prifti te vertéte:
Rrofte veshti dhé dheria,
Rrofte véra dhé rakia
Q' i-ka bere Pérendia;
Sé dhé Zot' i-Krisht gne hére
Mori uj' é-beri vére.
Moj vére, burim i-ghakut,
Gaz' i-djalit é i-plakut,

O raki moj bukuroshé,
Qe na héth qoshé me qoshé. . .
Sé ch' ben véra dhé rakia,
Pin' é déjén trimeria,
Sa vjén rotule shtepìa. . . .
Dét i-math é dét i-ghére
Psé s' te beri Zoti vére
Sé dot' a pinim pa blére.

IV.

(Eshte nate: krushqit zen' é ikine duk' é uruar memen é dhenderrit: zognen Tane q' eshte shum' é-gezuar.).

Nuni. Te te trashegonén.
Brodani. Si bléte te shtonén,
Abazi. Mé jéte t' u-rrojne,
Prifti. Dhé t' u pléqerojne.
Zogna Tane: U pacha, te rroni,
Ghithe te gezoni.

(Gne nga gne ikin te tere dhé mbétén vétem nd' o.le Tana mé djal' é mé nusé).

(Zana ték i-biri).

Rri mé nusén, djale,
Dhé foli dy fjale
Te mos kéte frike.

(Dhenderri thote s' emese).

Ngréu mem' é ike. (Tana iken).

V.

(Dhenderri mé nuséne mbéténe vétem).

Dhenderri :

Lozem no gne loder. ?
Te dua si moter. .

Nusia.

Ch' moter me ké mua
O lum' é perrua ? . . . .
Ti me moré grua .

Dhenderri :

Psé u-zemerové
Dhé u-hidhenové ?
Kur s' lot no gne loder,
S' te dua si moter,
Te dua si meme ! —
Po hajdé te fleme . . . .
Sé me mori ghumi.

Nusia :

Fli te marte lume ! .

BKSH

RADHUA I VJÉRSHAVÉT.

Dy fjale	Faqé	3.
Baba-Tomorri	»	9 — 13.
Memedhén	»	14.
Shqipetar	»	15 — 18.
Ku kémi lére	»	19.
Trim' i Shqiperise	»	20.
Deshir' é Skénderbéut	»	21 — 23,
Sultani	»	24 — 28.
Prishij' é Lekursit	»	29.
Luft' é vitit 1896	»	30.
Vaj	»	31 — 34.
Roberia	»	35 — 36.
Bésa-bése	»	37 — 39.
Ch' jémi	»	40 — 42.
Punerat' é Perendise	»	43 — 44.
Naim-bé Frasheri	»	45 — 46.
Atdhéu dhé dashuria	»	47 — 53.
Varferia dhé Liria	»	54.
Fshati im	»	55 — 56.
Dhéu.	»	57.
Aleksander' i Math	»	58.
Dashuria	»	63 — 70.
Vajé	»	71 — 76.
Zoléjka	»	77 — 87.
Kopshti i Dashurise	»	87 — 89.
Plaku	»	89 — 91.

Bksh

Nvja Tri . . . . . Faqé 92 — 94.
Kasap' . . . . . » 94 — 96.
Fyélh' i Bariut . . . . . » 96 — 97.
Deshire . . . . . » 98 — 117.
Misiri . . . . . » 121 — 124.
I Krishteri dhé Chifuti . . . . . » 124 — 126.
Kurbéti . . . . . » 127 — 134.
Gomari jatro . . . . . » 134 — 135.
Jét-e lige . . . . . » 135 — 136.
Ujku békshi . . . . . » 136 — 137.
Gne dzadza . . . . . » 137 — 138.
Néron i-ri . . . . . » 139 — 140.
Mik mé dy fytyre . . . . . » 140 — 141.
Korbi dhé Dhélpra . . . . . » 141 — 142.
Dhélpra dhé gne koke Gréku . . . » 142
Gruaja mé barre . . . . . » 143.
Lopa, dhia, délia, dhé aslani . . » 144.
Qéni dhé hiéja . . . . . » 145.
Ujku dhé qenghi . . . . . » 146.
Eva dhé Shéjtani . . . . . » 146.
Shtate hére fajtor . . . . . » 147.
Gnériu i-shtrenguar . . . . . » 147 — 148.
Gréku dhé Shqipetari . . . . . » 148.
E-Shtume ! é-Diéle . . . . . » 148 — 149.
Burri mé grua . . . . . » 150.
Dreri . . . . . » 151 — 152.
O bobo . . . . . » 153.
Farferia . . . . . » 154 — 155.
Katrembedhjéte vjéch dhenderr . . » 156 — 191

BKSH